

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 204, Tetor 2020
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

2 DUKAGJINI HISTORIK APO BASHKËSI I NJË RENDIT TË ULTË PARA POLITIK?!

KUVENDI I DUKAGJINIT 18 TETOR 2020

Po ishte një kuvend i ngjashëm me atë të kuvendeve të moçme, por në një stad më të lartë. Aty ishin përfaqësues nga të gjithë hapësira e kësaj treve. Më erdhi mirë se pati përfaqësues nga Nikaj, Merturi e Shllaku, të cilat politika i ka ndare nga bashkësia e madhe heterogjene e Dukagjinit. Nuk ishte një kuvend krerësh, por pinjollët aty ishin. Nuk qe kuvend intelektualësh, por aty ishin dhe i dhanë tonin. Nuk qe kuvend partiak, por për politikë u diskutua dhe u mor një vendim. Kuvendi mbledhi përfaqësues të gjitha shtresave e bindjeve, madje për herë të parë kuvendarët diskutuan dhe vendosën të ngrihen mbi ndasitë dhe mjerimin politik që kanë mbjelle ish të dashurat e tyre për gjate këtyre 30 viteve. Të gjithë pranishmit ishin të bindur në rrënimin politik, ekonomik madje dhe moral që politika i polli jo vetëm të Dukagjinit si identitet, por të gjithë vendit tonë në tersi. Se çfarë u diskutua dhe çfarë vendos tashmë janë bërë publike dhe duhen përshëndetur dhe mbështetur pa rezerva.

4 PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Z. ILIR META VLERËSON LUFTËN E KOPLIKUT DHE MALËSINË E MADHE

VEPRIMTARI KULTURORE, NË NDERIM TË LUFTËS SË KOPLIKUT NËN KUJDESIN E VEÇANTË TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Z. ILIR META

Ditën e shtunë me datë 10 / 10 / 2020 te Bar Restorant "Besjoni i Ri" në Koplik të Malësisë së Madhe u organizua një takim përkujtimor, me rastin e 100 vjetorit të Luftës së Koplikut nën kujdesin e veçante të Presidencës dhe vetë Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, i cili me prezencën e tij i dha vlera nacionale asaj qëndrese heroike të malësoreve trima.

Një organizim solemn zyrtar i planifikuar dhe protokolluar edhe në fletoren zyrtare të këtij institucioni, pas një kërkesë të shoqatës kulturore "Kënga e jonë" dhe drejtuesit të saj z. Rrok Gjellaj. Në këtë përkujtimore morën pjesë malësore nga të dy anët e kufirit, Shqipërisë dhe Mali të Zi, ku ra në sy prezenca e delegatëve të Komunës së Tuzit, malësoreve dhe intelektualëve nga Dukagjini, njëkohësisht përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me Kryetar z. Ndue Sanaj, si dhe përfaqësues të shoqatës "Mirdita"-dega Shkodër, z. Zef Gjini, Mjeshtër i Madh dhe instancave më të larta të qarkut Shkodër e më gjere. E pranishme ishte edhe Kryetarja e Bashkisë Shkodër znj. Voltana Ademi, përfaqësues i Komunës së Tuzit, z. Nikoll Camaj, përfaqësues të forcave politike opozitare z. Agron Çela, z. Edmond Ndou, z. Fatmir Shpellzaj, z. Ramadan Likaj e shumë personalitete të tjerë që punojnë e veprojnë "në", dhe "për" Malësinë e Madhe, si biznesmenë, studiues, gazetarë e të afërm, "trashëgimtarë të martirëve të lirisë" siç i cilësoi në fjalën e rastit Presidenti Meta. Ajo që ra në sy më së shumti në këtë përkujtimore ishte mungesa e të "Zotit të Shtëpisë" ...

3 "FESTA E GËSHTENJËS"

- LINDI NJË RISI NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SHLLAK, SHPRESOHET TË KTHEHET NË TRADITË TË PËRVITSHME-

Ishte thjeshtë një ide e kameramanit dhe fotografit Mark Gjeka, ndërsa sot u kthye në një realitet. "Festa e Gështenjës" ka shënuar lindjen e një risie të re në Njësinë Administrative të Shllakut. Pse pikërisht "Festa e Gështenjës"? Sepse është frutë tradicional i kësaj zone, me qindra hektarë, ...



PRELË SOKOLI, MBI NJËQIND-VJEÇARI I MIRË

Mirë ka thënë një njëri i mençur, se të moshuarit janë biblioteka të gjalla, madje ai shkon edhe më tej kur thotë se, vdekja e tyre është si me u djegë një bibliotekë.

Prellë Sokol Skollaj u lind në Gimaj të Shalës, më 28 shtator 1920, ...



DUKAGJINI HISTORIK APO BASHKËSI I NJË RENDIT TË ULTË PARA POLITIK?!

KUVENDI I DUKAGJINIT 18 TETOR 2020



Po ishte një kuvend i ngjashëm me atë të kuvendeve të moçme, por në një stad me të lartë. Aty ishin përfaqësues nga të gjithë hapësira e kësaj treve. Më erdhi mirë se pati përfaqësues nga Nikaj, Merturi e Shllaku, të cilat politika i ka ndare nga bashkësia e madhe heterogjene e Dukagjinit.

Nuk ishte një kuvend krerësh, por pinjollët aty ishin. Nuk qe kuvend intelektualësh, por aty ishin dhe i dhanë tonin. Nuk qe kuvend partiak, por për politikë u diskutua dhe u mor një vendim. Kuvendi mbledhi përfaqësues të gjitha shtresave e bindjeve, madje për herë të parë kuvendarët diskutuan dhe vendosën të ngrihen mbi ndasitë dhe mjerimin politik që kanë mbjelle ish të dashurat e tyre për gjate këtyre 30 viteve. Të gjithë pranishmit ishin të bindur në rrënimin politik, ekonomik madje dhe moral që politika i polli jo vetëm të Dukagjinit si identitet, por të gjithë vendit tonë në tersi. Se çfarë u diskutua dhe çfarë vendos tashmë janë bërë publike dhe duhen përshëndetur dhe mbështetur pa rezerva. Ky kuvend tregoi një vizion përtej interesave të vogla, personale, fisnore, politike, por mbi të gjitha u ngrit mbi miopinë e turmave para politike fanatike, që kanë vallëzuar sa andej si pula pakrye pa bërje pendese. Shihej qartë në fytyrat e çdo pjesëmarrësi për-

çmimi ndaj idiotësirave dhe u manipulimeve tragji-komike të së shkuarës, të cilat i kemi kapërdi duke na lënë jashtë çdo përfaqësimi politik. Ky Kuvend dhe kandidati i pavarur që lufton të garojë për këtë kuvend e kanë të qartë se ke kanë përballë tre përbindësh politik të pa skrupullit që kanë forcën, paranë dredhinë dhe pabesinë si armët vrastare. Ky kuvend tregoi se Dukagjini nuk mund të qëndrojë si qeni i rrahur pas dere duke pritur ndonjë kockë që do i hellin lugetërit e pa ngopur të politikës. Ky Kuvend dëshmoj se nuk mund të kapërdihet më që dukagjinasi të blihet se derrat në teqe dhe as të përdorën si hunj në duart e tamburxhive, që sulen yrysh drejt pushtetit. Ky Kuvend ishte i vetëdijshëm se vota, që po u kërkon bijve të vet, është votë për dinjitetin e nëpërkëmbur, është përgjegjësi historike pasi Dukagjini është gjallë dhe nuk ka vdekur. Është proteste ndaj dështimit katastrofal të politikës. Është dore e shtrire pajtimi dhe urë e re mbi hendekun e përbuzjeve, urrejtjeve xhelozive të trashëguara nga kaluara të thelluar ndoshta më shumë se kurrë nga politika. Në atë Kuvend nuk mund të merrte pjesë i gjithë Dukagjin nga 17-70-të, por kuvendarët duhet ta të shkojnë te dukagjinasi ku do që janë t'i bindin e të bëjnë vetën pjese e përgjegjësisë, me rezultate konkrete.

Së pari, duhet thye miti inferioritetit mjeran i njerëzve tanë, të cilët mendojnë se çdo kush mund të behet deputet, por dukagjinasi jo.

Së dyti, po kaq e rrezikshme është egoja arkaike: Unë jam dhe as kush tjetër duke kaluar në ekstremin tjetër: Të gjithë duhet të jemi deputet, duke mos i hape askush rrugë shoqit, dhe përfundimi del askush.

Politika e madhe djallëzish ka hedhë ketë guralec në rrëgallinë, duke rrokul-

lisur dhjetëra të tjerë, duke bërë shumë zhurmë për asgjë. Kandidati i pa varur Pal Shkëmbi nuk është Shën Pali, por njeriu me guxim, idealist dhe me integritet të lartë, që ka 10 vite që gjithë intelektualëve të dukagjinit u ka shtri dorën e bashkëpunimit. Është fakt i pa mohueshëm, se na ka thënë të gjithëve pa dallim: - Urdhëroni e më prini se po

Pal Shkëmbin duhet ta mbështesim mbasi ka ngjeshë shpatën burrisht për ti kthyer Dukagjinit solin e grabitur nga ata që na kanë shtypë me bythë tash 30 vjet.

Pal Shkëmbi duhet mbështetur, se nuk ka imunitet të shkëlqyer ndaj korrupsionit, ka guxim ta thotë kudo fjalën e vet për Dukagjinin dhe ëndrra e sfida e jetës së



ju ndjek! Fatkeqësisht nuk i primë as nuk e mbështetëm se do ishim përfaqësuar së paku që vitin 2009.

Dështimet janë dialektike dhe të dobishme kur benë mësim. Mes militantëve të legjioneve të dështuara dhe njeriut që u betua gati i përplotur në Kryq dhe në Bibël :- Se do punoj për Dukagjinin si për familjen time.

Dukagjinasi e vërtetë, them se duhet të votojnë djalin e tyre, që është gati të bashkëpunojë me çdo forcë politike fituese, për të mirën e Dukagjinit.

tij, është të asfaltojë rrugën e Dukagjinit. Ky Kuvend nuk i shpalli askujt luftë, por i tha ndal së keqes!: Thirri, kushtrim Dukagjin deli zot vetit.

Ky kuvend, tha: Pal Shkëmbi le ti prijë kësaj lufte me të keqen tonë që kemi mes vetes. Është misioni historik ta fitojmë o sot o mot, në të kundërtën do zbulojmë lakuriq veten para shqiptarëve, se jemi bashkësia i një rendit të ultë para politik.

Prelë Milani

Histori të vogla, mesazhe të mëdha...!

Një ditë, njerëzit e fshatit vendosën të luteshin që të binte shi. Ditën e lutjes u mbledhën të gjithë së bashku, por vetëm një fëmijë erdhi me çadër: kjo gjë quhet BESIM!

Kur e hedh në ajër lart një fëmijë dhe ai qesh ndodh kështu sepse ai beson se do ta presësh në krahët e tu: kjo gjë quhet MIRËBESIM!

Çdo mbrëmje shkojmë për të fjetur pa qenë të sigurtë se do të jemi gjallë mëngjesin që vjen. E megjithatë, e vendosim gjithmonë zilen për t'u zgjuar: kjo gjë quhet SHPRESË!

Bëjmë projekte të mëdha për të nesërmen, megjithëse nuk e njohim aspak të ardhmen: kjo gjë quhet SIGURI!

Shohim vuajtje në botë dhe, megjithëkëtë, martohemi dhe kemi fëmijë: kjo gjë quhet DASHURI!

Një zotëri i moshuar mbante një triko me këtë shkrim: "Nuk jam 76 vjeç. Jam një 16-vjeçar me 60 vite përvojë": kjo gjë quhet AFTËSI (Praktikë)!

Ta jetojmë kështu jetën, me besim, mirëbesim, shpresë, siguri, dashuri dhe aftësi (praktikë).

Përgatiti:

Vëlla Nikolin Sh. Lëmezhi

“Festa e Gështenjës”

- LINDI NJË RISI NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SHLLAK,
SHPRESOHET TË KTHEHET NË TRADITË TË PËRVITSHME-

Ishte thjeshtë një ide e kameramanit dhe fotografit Mark Gjeka, ndërsa sot u kthye në një realitet. “Festa e Gështenjës” ka shënuar lindjen e një risie të re në Njësinë Administrative të Shllakut. Pse pikërisht “Festa e Gështenjës”? Sepse është frutë tradicional i kësaj zone, me qindra hektarë, ndoshta më shumë se ka sipërfaqe pyjore.

Në këtë risi, që u organizua për herë të parë në Shën Prende, Ukbibaj të Shllakut, morën pjesë mjaft persona, të lindur ose me origjinë të afërt e të largët nga kjo krahinë, por sigurisht, edhe të ftuar të tjerë.

“Sot organizuam për herë të parë festë e gështenjës, e cila besoj se do të kthehet në traditë për Njësinë Administrative të Shllakut.

Festa që organizuam sot, do të ishte shumë e vështirë të organizohej pa mbështetjen e pakursyer të bijve dhe bijave të Shllakut, të atyre që jetojnë në këtë krahinë të mrekullueshme, por edhe të atyre, që nuk i harrojnë asnjëherë rrënjët

e të parëve të tyre.

Shpresojmë që sot të jetë vetëm fillimi i një tradite të gjatë të “Festës së Gështenjës”.

Ju faleminderit te gjithëve!

Me respekt nga Mark Gjeka, shkruan organizatori i kësaj risie “Festa e Gështenjës”, i cili ia doli me sukses organizimit të veprimtarisë së parë të kësaj risie.

Tani vijimësia është në dorën e të gjithëve, duke nisur nga bijtë e bijat e Shllakut, qeverisja vendore, por edhe amatorët e piknikëve në natyrë, ushqimit dhe pijeve bio të krahinës e sigurisht, gështenjave!

Udhë të mbarë “Festës së Gështenjës”, kësaj risie të re, që synon veç të tjerave, promovimin e vlerave të Shllakut!

Përgatitur
nga **Mark Gjeka**



Kisha e Shën Prendes, në mes fshatit Ukbibaj e Vukaj



Mark Gjeka, organizatori i veprimtarisë së festes së Gështenjës



Fotografet e njohur të natyrës Jetmir Troshani e Ridvan Sokoli



Zgare e madhe me pjekë mish

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta vlerëson Luftën e Koplikut dhe Malësinë e Madhe

VEPRIMTARI KULTURORE, NË NDERIM TË LUFTËS SË KOPLIKUT NËN KUJDESIN E VEÇANTË TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Z. ILIR META

Ditën e shtunë me datë 10 / 10 / 2020 te Bar Restorant "Besjoni i Ri" në Koplik të Malësisë së Madhe u organizua një takim përkujtimor, me rastin e 100 vjetorit të Luftës së Koplikut nën kujdesin e veçante të Presidencës dhe vetë Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, i cili me prezencën e tij i dha vlera nacionale asaj qëndrese heroike të malësoreve trima.

Një organizim solemn zyrtar i planifikuar dhe protokolluar edhe në fletoren zyrtare të këtij institucioni, pas një kërkesë të shoqatës kulturore "Kënga e jonë" dhe drejtuesit të saj z. Rrok Gjellaj. Në këtë përkujtimore morën pjesë malësore nga të dy anët e kufirit, Shqipërisë dhe Mali të Zi, ku ra në sy prezencën e delegatëve të Komunës së Tuzit, malësoreve dhe intelektualëve nga Dukagjini, njëkohësisht përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me Kryetar z. Ndue Sanaj, si dhe përfaqësues të shoqatës "Mirdita"-dega Shkodër, z. Zef Gjini, Mjeshtër i Madh dhe instancave më të larta të qarkut Shkodër e më gjere.

E pranishme ishte edhe Kryetarja e Bashkisë Shkodër znj. Voltana Ademi, përfaqësues i Komunës së Tuzit, z. Nikoll Camaj, përfaqësues të forcave politike opozitare z. Agron Çela, z. Edmond Ndou, z. Fatmir Shpellzaj, z. Ramadan Likaj e shumë personalitete të tjerë që punojnë e veprojnë "në", dhe "për" Malësinë e Madhe, si biznesmenë, studiues, gazetarë e të afërm, "trashëgimtarë të martirëve të lirisë" siç i cilësoi në fjalën e rastit Presidenti Meta.

Ajo që ra në sy më së shumti në këtë përkujtimore ishte mungesa e të "Zotit të Shtëpisë" Kryebashkjakut, z. Tonin Marinaj dhe grupit drejtues, të nen punesave të tij, përfshi këtu edhe përfaqësuesit e forcës politike në pozitë, si individ, si qytetarë, si lider dhe si malësore, detyra ua impononte të ishin në krye të saj, pasi përfaqësojnë vullnetin dhe zërin e malësoreve, e në respekt të institucionit, duhej t'i bashkëngjiteshin kësaj përkujtimoreje me shumë kuptim për Malësinë dhe malësoret, gjë që mesa duket të gjitha këto detyrime i kanë varrosur bashkë me lapidarin e hequr për të vendosur ca pllaka guri e shtylla hekuri të konvertuara në "pare të thata" për xhepat e klientelistëve të "Rilindjes Urbanë", edhe pse ai lapidar ishte i vetmi memorial, i cili dëshmonte për atë qëndresë.

Megjithëse kam rezervat e mia si historiane për mungesën e ndriçimit të plotë të t'vërtetës ndaj asaj qëndrese gjithëpërfshirëse, çka u vu re edhe në kumtesat e malësoreve, pasi nuk dëshmuar sa, dhe si duhej, se; Lufta e Koplikut kishte, dhe ka, merita akoma më të mëdha, pasi falë asaj



qëndrese këto vise sot gjenden brenda territorit të Shqipërisë e vendi ku ishim mbledhur as që u përmend se ishte pika e referimit ku fare pranë gjendej banesa e Zef Luc Mullisit më shumë se 100 vjeçare, e cila meritonte po aq vëmendje kujtese, serish, i përgëzoj për faktet e reja që u dëshmuar para të pranishmëve, sidomos z. Mark Lucgjonaj për gojëdhënat dhe faktet që lidhen me dëshmitarë okularë.

Luftën nuk e bënë vetëm krrerët, ndaj duhet shumë kujdes në vlerësim, pasi ashtu si "plumbi" dhe "shpata" vrasin njësoj, po ashtu edhe meritat duhen çmuar me të njëjtën peshë, sidomos në një fushëbetejë.

Në këtë përkujtimore ra në sy gjithash-tu edhe mungesa e theksuar e studiuesve akademik malësor, njohës vlerësues dhe kritik, të cilët duhet t'i vendosin njëherë

e mirë pikat mbi "i" sa i takon asaj qëndrese dhe ta ngrënë në piedestalin më të lartë Nacional, ku dhe i takon me të drejtë.

Me vëmendje të shtuar dhe shumë interes u dëgjua dhe u mirëprit fjala e rastit e Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, i cili me atë maturinë në të shprehur që e karakterizon siç thonë malësoret "nuk i pikë fjala në tokë" e përshkroi atë qëndresë me dinjitet dhe vlerësim maksimal edhe pse ndoshta falë mungesës së informacioneve burimore akademike, pozicionit të tij juridik, si dhe nevojës për të mbajtur një qëndrim zyrtar, i

të mungonte as në këtë veprimtari. Me gjithë respektin për ata malësore, të cilët u dekoruan nga Presidenti, vlerësimi i parë dhe i vetmi maksimal i takonte gjithë asaj qëndrese, sidomos në këtë përkujtimore dhe Vit Jubilar, pastaj t'u jepej vlerësim individëve, të cilët janë me qindra, dhe aq me pak të kishte vlerësimeve jashtë kësaj kornize përkujtimore.

Me libretin e përgatitur me mjeshtëri nga intelektual i dukagjinasi z. Prel Milani dhe me interpretimin brilant të aktorese së teatrit "Migjeni" të Shkodrës znj. Rajmonda Marku, i gjithë programi ishte i gërshtuar me këngë, një pjesë e të cilave çuan peshë zemrat e të pranishmëve, sidomos ato të të rinjve malësor, Gabriel Rraposhi dhe Kjara Pepushaj.

U shpërndamë nën tingujt e këngës "Ku e muer emrin Malësia" të shoqëruar nga valltaret e rinj kelmendas të veshur me veshje tradicionale.

U largova me mendimin dhe shpresën, që një ditë jo të largët, uniteti malësor do të dijë t'i ftojë me këngën e kushtrimit "Maje krahu" bijtë e kësaj malësie nga të dy krahët e kufirit, t'i shtrojë rreth një treveze në këtë vend të gjere, për ta shkruar bashkë historinë e për ta dëshmuar burrinë, fisnikërinë dhe për ta mbrojtur me dinjitet urtinë e këtyre maleve, që peshojnë sa vetë jeta e të mos jetë kurrë më e nevojshme të na shpreh mirëseardhjen miku, e aq me pak të na mësojë të flasim, pasi kurrë nuk i kanë munguan mendimtarët e urtë dhe zë bylbylat Malësisë së Madhe.

Përulëmi me nderimin më të lartë për atë gjak të derdhur, plagët e renda e humbjet e jetëve të atyre malësoreve të përfshirë në këtë luftë, të cilët me durim, sakrificë dhe vetëmohim i mbrojtën këto troje nga grabitqarët dhe hienat që sulmuan pabesisht kohë pas kohe Malësinë e Madhe.

T'u jemi mirënjohës dhe përulëmi para kujtimit të tyre edhe për vazhdimësinë e jetës mbi këtë ultësirë të shkruaruar e zhuritur sa asnjë vend tjetër në Ballkan.

Mirënjohje pafund Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta për vëmendjen institucionale në vlerësimin e kësaj qëndrese heroike të malësoreve në vitet 1920-1921.

Nuk ka asnjë vlerë të nderosh të gjallët e të harrosh të vdekurit, sado pushtet dhe para të kesh, ndaj respekti për ta është dinjitet.

"Ndërsa ju malësore të munguar mos harroni se toka e Malësisë ku shkëlqi dhe do preheni një ditë, nuk i falë kurrë mosmirënjohësit dhe tradhtarët e kauzës së shenjtë të dinjitetit dhe besës së shkelur".

Nga Rita Shkurtaç, Tetor 2020

PRELË SOKOLI, MBI NJËQIND VJEÇARI I MIRË

Mirë ka thënë një njëri i mençur, se të moshuarit janë biblioteka të gjalla, madje ai shkon edhe më tej kur thotë se, vdekja e tyre është si me u djegë një bibliotekë.

Prelë Sokol Skollaj u lind në Gimaj të Shalës, më 28 shtator 1920, që përkon më Natën e Shëmhillit (Shën Mëhillit). Në leternjoftim e ka datëlindjen me 10.9.1920, por thotë se është bërë gabim sepse, “si më kanë thanë baba e nana kam le natën e Shën Mhillit. (kjo festë fetare ka natën me datën 28 dhe ditën më 29 shtator). Familja e tij ka qenë e madhe, por në vitet '30, të shekullit të kaluar, pati shumë vdekje dhe mjaft të shpeshta, veçanërisht mosha të reja. Mbetën shumë fëmijë jetima dhe i duhej Prelës që të përpiquej që ti rriste. Madje ai thotë “... rritë fëmijë e mbaj pleq...”.

“Mirë boll e kam kaluar, përgjigjet Prelë Sokoli, i cili ka 5 ditë që ka kaluar njëqind vjet. Në fakt ai vështirë se e ka kaluar një shekull “mirë boll”, por Prela, me atë krenarinë e malësorit, nuk dëshiron që të jepet, nuk do të bëjnë viktimën, por dëshiron që të qëndrojnë krenar. Natyrisht jeta ka shumë probleme, dhe në një kohë njëshekullore pa tjetër që ka pasur edhe shumë vështirësi.

Vështirë të bësohet kur të thonë se i ka mbushur 100 vjet. Por kur e shikon vetë bindesh plotësisht, apo kur tregon ngjarje të ndryshme dhe bëhen krahasimet. Është trup vogël por shumë i shkathhtë, me një kujtesë për tu admiruar, me të folur shumë të rrjedhshme, i pa impresionuar nga ata që takon dhe e pyesin. Të pret e të përcjellë në këmbë, të bën shërbim në tavolinë, e të nxitë për të pirë apo për të ngrënë, të bën të qëndrosh shumë lirshëm e të ndjehesh si në shtëpinë tënde.

Është martuar në vitin 1951 me Sutë Paloken nga Lotajt e Shalës në një familje tradicionalisht me cilësitë më të mira e mikëpritëse për mikun e bijën, rrugtarin e shtegtarin. Suta ishte 16 vjeç. U desh që të rritej mosha me gjyqë. “Fejesa është ba me ndërmjetësim, por unë e kisha pa dhe isha dakord. Kishte edhe familje shumë të mirë për gjithçka. Me këtë punë u morën familjarët e mijë e të afërmit”. Prela dhe Suta patën 9 fëmijë, dy prej të cilëve janë ndarë nga jeta në moshë të re.

“Kemi jetue me shumë vështirësi, por kishim marrëdhënie shumë të mira me njani tjetrin, i nëjshim shumë gati dhe ndihmonim njani tjetrit për çdo gja që kishim nevojë”. “Jetë e vështirë por e bukur”, thotë Prela, pasi pushon pak. Prela jeton në një shtëpi me komoditet normal në qytetin e Shkodrës, por “edhe andrrat i shoh vetëm në Gimaj e në Shalë”, thotë Prela.

Një vëlla e ka pasur ushtarak dhe ka dalë në pension në atë profesin. Që nga largimi për në shkollë ka ardhur vetëm për mik në Gimaj. Ai ka thënë Prelës që të shkante afër tij atje ku jetonte ai, në rrethin e Lezhës. Prela pranoj, por, axha



i tij, Qerimi Delia, i kishte thënë “në daç me shkue shko, por sot vrana ne, nesër vorrosna dhe masnesrit shko ka të duesh”. Kjo e bani Prelën që të mos shkante.

I vjen koha e ndarjes së familjes pasi u rritë numri i pjesëtarëve. Prela merr mbi vete të gjithë borxhin që kishin si debitor në kooperativën bujqësore dhe për kohën ishte mjaft i madh. Në vitin 1967 hynë në kooperativën bujqësore. U dorëzuan shumë bagëti të imta, lopë e qe, dhe mjete pune. Jeta ishte mjaftë e vështirë për tu përballuar, veçanërisht ata që nuk kishin krahe pune për të punuar.

Për të shlyer borxhin në kooperativë dhe për të ndihmuar në rritjen e fëmijëve Prela ka punuar 13 vjet në hidrocentralin e Fierzës dhe të Komanit, dhe disa vite të tjera në mirëmbajtjen rruga-ura. Është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dy herë dhe një herë ka marrë flamurin si punëtori më i dalluar në brigadën e tij. “Ka punue si xhullini me mbajtë ne, por edhe për të shlyer borxhet që u trashëguan”, thotë djali i tij, Martini. Prela kujton me respekt Mhill Ndojën ish kryetari i kooperativës Gimaj në atë kohë,



Lulash Markun, Prelë Sejdinë e të tjerë, të cilët e ndihmuar me mkamë familjen.

Prelë Sokoli ka qenë partizan me Brigadën e 24 sulmuese nga fillimi i nëntorit 1944 deri në fund shkurtin e vitit 1946. Pas kërkesës së tij është liruar nga ushtria për të ardhur pranë familjes. “Më kujtohet, si sot, se atë ditë që do të lirohesha unë, në nadje, janë pushkatue Gjelosh Lulashi, Pader Gjon Shllaku, Fran Miraka, etj”- thotë Prela.

“Gëzimi (lumturia) nuk ka nëj me mue g’jatë, kam pasi shumë vështirësi nga sëmudnjat dhe vdekjet në famijen tëme të madhe dhe në krahin tëm”, thotë Prela, por mjaft i fortë, megjithëse nga njëherë i skuqen sytë, por e merr veten shpejt.

Krenaria e malësorit për ti shërbye deri në pikën e fundit të afërmit ka qenë dhe është nxitje në tërë qënien e tyre. “Kisha vëllanë e smurë në gradë të fundit, mënonim të gjithë se nuk e ka të gjatë jetën. Në atë kohë burri duhej të varrosej me xhamadan e tirq. Tirqët i kishim por, xhamadan jo. Lash vllanë e sëmure dhe dola për të kërkue një xhamadan borxh. Ma në fund e gjeta xhamadanin por kur u ktheva në shpi, Çuni (vëllau) kishte pas dekë”.

Unë nuk e dija, por më thotë Martini, pyete për alfabetin. Unë pa pasur besim, e pyeta, vetëm për ti plotësuar dëshirën Martinit. U habita kur ky burrë në moshën mbi njëqind vjeç më thotë alfabetin rrjedhëm, dhe me vetëm dy gabime. Ai s’ka qënë asnjë ditë në shkollë, ka mësue shkrim e këndim prej ndonjë që ka ditë. “Shkruekesh në hinin e votrës me një shkop se nuk kishim të tjera mjete. Kur ma pruni dikush një abetare

jam gëzue shumë, thotë Prela. “E merrsha me vete gjithmonë kur shkojsha me bagëti, mësova shkrim e këndim”. Prela ka ndihmuar edhe disa që i kishte afër shtëpisë, apo shkonin bashkë me bagëti, që të mësonin shkrim e këndim. Por është interesant se mësoj aq mira sa ka lexue “Lahutën e Malësisë”, “Kanunin e Lek Dukagjinit”, gazeta të kohës si “Axhitatori”, “Zeri i Popullit”, etj. Një shumicë të madhe të këngëve nga “Lahuta e Malsisë” i ka ditur nga fillimi në fund deri në vitet e fundit për ti thënë përmendësh. “Kur kam këndë ushtar, thotë djali i tij Martini, letrat që më çonte mua i shkruante vetë, dhe ato që i çojshë unë i lexonte vetë, pa pasë nevojën me ja lexue askush”.

“Kemi pasi jetue shumë keq në të kaluemen, vesheshim me shguna (shajak) prej leshit të deleve apo të dhive, me lëkurën e bagëtive të trasha bënim opingat. Nganjëherë përdorinim edhe lëvoren e pemëve të ndryshme si shelgut, arrës, blinit, etj”- thotë Prela. “Po përmendi edhe dritën elektrike. Në të kaluemen kemi jetue me dritën e pishës, kur u fut kandili na u dukë e jashtëzakonshme, e kur erdhi drita elektrike sikur hyni dielli në shpi”.

Prela e quan si veprim shumë të keq vlerësimi si u bëhej grave në të kaluarën. Ndërsa bisedonim më shkojnë sytë në dorën të tij dhe shikoj një unazë, më tërhoqi vëmëndjen dhe e pyes së pse e mban në gisht. “Eh, thotë Prela, dhe nis e na tregon. “Këtë unazë e kam në gisht qysh kur më ka dekë gruaja, tri ditë pa dekë ma ka dhanë gruaja dhe qyshë atëherë e kam vu në gishtin tëm dhe do të mbaj si kujtim prej saj sa të jam gjallë, bile edhe në vorr due me ma lanë në gisht. Kena kalue shumë kohë bashkë dhe nuk jemi thye asnjëherë me njani tjetrin. Më ka ndihmue në punët që kam pasë unë dhe unë i kam ndihmue në shumë punë të shpisë. Kemi shkue mirë shumë bashkë, nuk ma ka prishë asnjë herë, megjithëse të vjetër te dy, mu ka dhimtë boll kur më ka dekë, masandej asht nana e fëmijëve që janë shpirti, gjaku, zemra e jeta jonë”.

Prelë Sokoli del në pension në vitin 1985 në hidrocentralin e Komanit. Edhe pse doli në pension dhe erdhi në shtëpi, u muar me kopështin personal pranë shtëpisë, duke ndihmuar mjaft në ekonominë familjare.

Jeta e Prelë Sokolit është e mundimshme, por ai ka qëndruar gjithmonë i pamposhtur. Kudo që ka punuar dhe me këdo është takuar, në rrugë apo shtëpi, ka dhënë dhe ka marrë respekt prej të gjithëve. Kjo duket edhe tashti nga vizitat dhe takimet e shumta të miqëve. Prelë Sokoli është një shembull i shkëlqyer për brezin e ri dhe brezat që do të vinë. Urime Prelë Sokoli, edhe shumë vite me plot shëndet dhe mirësi personale dhe familjare.

Luigj Shyti
2.10.2020

Gruaja-viktimë e traditave të përlijura



Femra, nga natyra, lindet njeri por, pushteti mashkullor e tjetëron atë në "send". Historikisht, gruaja njeri, ka qene pjesëtarë aktive, në të gjitha rastet vendimtare për shoqërinë dhe nocionin. Nuk janë të pakta rastet kur gratë, për krah etërve dhe burrave të tyre, u hodhën në fushën e betejës kundër pushtuesve për të mbrojtur vatanin e tyre.

Historiani, Nikolai Karamsin, thotë se, 400 vjet para Krishtit, gruaja athinase u hodh në fushën e betejës për krah etërve dhe burrave të tyre, në luftë kundër pushtuesve.

Aleksandri i Madh (356-323) ishte shembulli tjetër që i angazhoi gratë në luftë, direkt në fushën e betejës.

Në vitin 626, në Konstandinopol, në mes të të rënëve sllavë në luftë kundër grekëve, u gjetën një numër i madh kufo-mash grash. Karamsin shkruan se: Gratë sllave shkonin në luftë, pas etërve dhe burrave të tyre, pa pasur frikë nga vdekja.

Në vitin 1560-1620, në Angli gratë u mobilizuan për shërbime shëndetësorë ndaj të plagosurve në luftë.

Në luftën e Parë Botërore, u aktivizuan 100 mijë gra, gjermane, ruse franceze, direkt në luftë.

Lufta e Dytë Botërore do të ishte ajo që, gjatë gjithë historisë së njerëzimit, do të mobilizonte numrin më të madh të grave në luftë. Amerika mobilizoi 45 mijë, Anglia 225 mijë, Gjermania 500 mijë dhe rekordin e mbajti Bashkimi Sovjetik me mbi një milion. 26

As që nuk mund të numërohen aktet patriotike dhe heroike të gruas shqiptare, në luftë për mbrojtje dhe zhvillim të vendit.

Dhe, megjithatë, gruaja për botën mashkullore, ka mbetur "send". Papërshatshmëria e femrës në shoqëri, e favorizoi plotpushtetshme rinë e mashkullit, duke e kthyer atë në kult. Që kur gruaja u "ndërgjegjësu" për pozicionin e vet inferior në shoqëri, u shtuan teoritë dhe ideologjitë për shfrytëzimin dhe dhunimin e saj.

Nëse duam të kuptojmë, përse gratë vazhdojnë të jetojnë aty ku dhunohen me ata që i dhunojnë, duhet kuptuar edhe (ideologjitë) mekanizmat që e mbështesin dhunën dhe poshtërimin ndaj saj.

Mitet e lashta të inferioritetit të gruas ndaj burrit, i shërbejnë shoqërisë së sotshme për të justifikuar të drejtën mashkullore si forcë qeverisëse, në familje dhe shoqëri. Gjurmët e këtyre miteve ne i gjejmë, të paktën, para 2500 vjetësh dhe si në formë virus, kalojnë nga gjenerata në

gjeneratë, pa u dobësuar aspak.

Mary Metzger, mendon se, të paktën janë tri "teori" kryesore që e mbajnë të gjallë këtë virus.

"Teoria" e parë, e koncepton gruan "burrë i mëngët". Asaj i mungon nga natyra diçka dhe këtë diçka e kanë vetëm burrat. Aristoteli, këtë diçka e mendonte "paaftësi e gruas për të prodhuar spermë". Sipas Freudit, kjo diçka, është mungesa e penisit.

"Teoria" e dytë mendohet natyra e njeriut, e krijuar kjo në mënyrë të pabarabartë, mashkull dhe femër. Sipas këtij motivi, kufiri midis burrit dhe gruas është natyrorë. Forca, agresiviteti, pasiviteti, vartësia, janë burimet e këtij shembulli.

"Teoria" e tretë vjen nga mitologjia klasike e krishterimit çifut sipas të cilës gruaja u krijua si nevojë e burrit. Zoti e krijoj Evën si ndihmëse të Adamit. Kjo teori gjeti përhapjen dhe përkrahjen më të gjere në gjithë njerëzimin. Edhe sot e kësaj dite gruaja mendohet e tillë, makine lindëse, fshesë, kuzhinë, krevat. 27

Këto teori janë mekanizmat mbi të cilat meshkujt mbështeten, gjithnjë e më shumë, si burim i të drejtës së tyre për të sunduar gratë. Ato mendohen burimi themelorë i të drejtave të meshkujve mbi femrën, si pronë e tij. Gratë që guxojnë të sillen ndryshe nga tradita, nga sa është parashikuar nga shoqëria dhe burri, ndëshkohen me dhunë, rrahje, torturë, përdhunim, me vdekje ose, me forma të tjera të parashikuara sipas rastit në "ligjet" e shoqërisë mashkullore.

Nga historia e së kaluarës ne e dimë se, dhuna ndaj gruas ka qene e hapur dhe e përlijur. Antropologia Ruby Rohrllich-Leavitt, thotë se, në kultura të ndryshme, emri i gruas që kundërshtonte burrin, gdhendej në tullë me të cilën ajo go-ditej në dhembë. Një veprim i tillë ishte i ligjësuar.

Kodeksi i Hamurabit, 1728 para Krishtit, e mbështeste një veprim të tillë, shenjtoronte familjen dhe përlijte sjelljet e saj të dhunshme ndaj gruas. Soloni, si ligjvënës i Greqisë së lashtë, shkruante se: -Gruaja që tradhton burrin (në atë kohë në ligj, për tradhti bashkëshortore ndëshkohej vetëm gruaja) nuk guxon të zbulohet dhe as të marrë pjesë në festat publike. Nëse ajo guxon, çdo burrë ka të drejtën t'ia rrëmbejë stolitë nga trupi dhe ta rrahë.

Në Romën e lashtë shprehja "Patria Potestas" do të thoshte pushtet absolut i burrit mbi gruan, fëmijët dhe skllëverit. Deri në ekstrem sundonte dopiomorali. "Nëse gruaja e tradhton burrin, burri ka të drejtë ta vrasë atë pa gjyq"; nëse burri shkon me gratë e huaja, edhe nëse i barëson ato, nuk i preket as gishti", kështu thuhej në ligj. 29

Pirja e verës (çka nënkuptonte të qenet me burrat e huaj dhe mendohej thyerje martesë) ishte e ndaluar për gratë. Gratë nuk guxonin të grindeshin afër fuçive të verës dhe as tu afroreshin atyre gjatë kohës së menstruacioneve pasi thartohej vera.

Në Evropën mesjetare, burri kishte të drejtë, ligjërisht, ta rrihte gruan. Të gjitha

sistemet ligjore e përlijnin një gjë të tillë. Në të drejtën franceze, në shekullin XIII, thuhej: -Ligjërisht, nëse burri e rrahë apo vret gruan e vet, është e drejta e tij kur ajo, ja jep trupin e saj dikujt tjetër, kundërshton, fyen, nuk respekton. Në të gjitha këto raste dhe të tjera të ngjashme me këto, burri ka të drejtë ta rrahë dhe ndëshkojë gruan sipas vendimmarrjes së vet.

Pushteti i burrit mbi gruan, në Anglinë mesjetare, ishte rregulluar kështu me ligj: -Nëse burri rrahë, ndëshkon apo syrgjynose tradhtarin, paganin, gruan e vet, kjo nuk përbën krim dhe as shkelje të ligjit". Deri në shekullin e XVII, në Angli, burrat kishin ligjërisht të drejtë që ta rrihnin gruan me shkop, por me kusht që shkopi të mos ishte më i trashë se gishti i madh i tyre.

Në Kaliforni, deri vonë ka ekzistuar një ligj i cili mendohej i paligjshëm, sipas të cilit: "Burri duhet ta rrahë gruan çdo ditë, pas orës 22 të mbrëmjes".

Fillimi i fazës së kapitalizmit solli ideologji të tjera dhe për rrjedhojë, norma të tjera të dhunimit të gruas. Studimi i teorisë së evolucionit dhe psikologjisë, nuk solli ndonjë ndryshim në lidhje me qëndrimin ndaj gruas. Ajo përsëri u mendua si njeri i dytë dhe një shtesë e burrit. Nëse dhuna ndaj gruas nuk u mbështet më ligjërisht, nuk ju kushtua ndonjë vëmendje duke e justifikuar me natyrën agresive të meshkujve (maoizëm ndaj grave). Edhe sot e kësaj dite, analistë të ndryshëm, duke u mbështetur mbi teorinë maqoiste, thonë se gruaja, herë pas here, e ka të nevojshme ndëshkimin fizik.

Filozofi Herbert Marcuse mendon se: -Suksesi i sistemit qëndron në rigjallërimin e heshtur të traditave të vjetra". Nëse është kështu, atëherë kjo duhet menduar bërthama e ligësisë ndaj gruas.

Sipas traditës dhe kulturës patriarkale, gruaja është menduar dhe vlerësuar thjeshtë si pronë e burrit, pronë me të cilën ai mund të sillet dhe veprojë si të dojë. Gruaja është një send i blerë pasi, në të vërtetë ajo blihej. Sipas shumë analistëve, martesë ka qene thjeshtë një çështje tregtie. Gruaja, si send i blerë, kishte vetëm detyra. As që bëhej fjalë për të drejta. Detyrat e saj kryesore ishin, të shkante e virgjër tek burri, të lindte fëmijë, dhe sa më shumë djem dhe t'i bindej burrit. E gjithë jeta e saj zhvillohej në trekëndëshin, fshesë, kuzhinë, krevat.

Çmimet e shitblerjes së gruas ishin të ndryshme. Në shekullin e XIX, në gadishullin Ilirik, një vajzë kushtonte, një herë 3000 piastra dhe një herë tjetër 300 piastra. Çmimi varej nga dera nga dilte vajza dhe nga oferta dhe kërkesa e tregut. Gratë e përdorura (vejushat), për çdo rast shiteshin dhe bliheshin shumë më lirë se ato të papërdorurat. Dhe nëse do të ishte cilësi e tretë, më shumë se dy herë e ndarë apo vejush, ajo mund të këmbehej me një pushkë. Nëse blerësi nuk kishte para kesh, blerja bëhej me lopë, qe, kuaj, mushka dhe kafshë të tjera. Gruaja, nga dita që dilte nga shtëpia e prindërve, nuk gëzonte më asnjë të drejtë aty.

Një traditë e tillë ka qene e njohur në të gjithë Shqipërinë. Sipas J. G. Hans, në

Shqipërinë e jugut, çmimi i gruas ishte sa vlera e një kali. Në Kosovë çmimi i gruas ishte më i lartë. Në periudhën midis dy luftërave botërore, çmimi i gruas u rrit aq shumë sa i varfëroj familjet.

Sipas ligjit, prindërit e gruas kishin të drejtë t'i kërkonin shtëpisë së dhëndërit të ashtuquajtura dhurata me vlerë deri në 100 Gulden.

M. Mitterauers, thotë se, në të gjitha kulturat ku gruaja blihej, ajo kthehej në pronë të familjes. Nëse i vdiste burri, sipas traditës së ligjësuar, levirat-it, ajo detyrohej të martohej me vëllain e burrit ose me cilindo tjetër brenda familjes dhe fisit, sipas vendimit të të parit të familjes.

Sipas Kaser, në shumë fise shqiptare, levirati ka qene i përhapur. Dhe kjo jo vetëm në fiset myslimanë ku, sipas të drejtës së Sheriatit, poligamia ishte e ligjësuar. Burrat, në kundërshtim me moralin kishtar, e ndjenin veten të detyruar që e veja, të martohej me cilindo, brenda familjes dhe fisit, me përjashtim të babait. Në fillim të shekullit XX, në shumë fise katolike, levirati ishte ligj i detyrueshëm.

M. Filipoviç, thotë se, në Dukagjin dhe Mirditë, sipas traditës, të parët ishin vëllezërit e vëllait të vdekur që gëzonin të drejtën e martesës me gruan e tij të lënë pas. Pastaj vinin meshkujt e tjerë të gjinisë dhe të fisit.

Mary Edith Durham (1863-1944) shkruan se, megjithëse kisha e ndalonte leviratin, burrat katolikë të Shqipërisë së Veriut e kishin ligjësuar atë dhe e mendonin si akt normal. Në raste të tilla, e gjithë familja çkishërohej. Durham vizitoj një familje me tetëmbëdhjetë anëtarë në Aprripën e Gurit (Pukë) ku të gjithë ishin çkishëruar për një rast të tillë. Njëri nga djemtë, 30 ditë pas vdekjes të vëllait, ishte martuar me gruan e tij. Megjithëse çkishërimi nuk ishte i lehtë, djali e ndjente për detyrë të martohej me gruan e vëllait të vdekur.

Në krahinat shumë të thella të Nikaj-Merturit, Toplanë, Berishë, në fillim të shekullit XX, levirati ka qene jo vetëm normal por, edhe i detyrueshëm. Në fisin Nikaj me 300 shtëpi, kishte 50 raste të leviratit, në Merturë, me rreth 300 shtëpi, kishte 45 raste.

Nga tradita të tilla, të cilat u përlijën nga pushteti mashkullor ndër shekuj, gruaja u transformua substancialisht në një qenie me pushtet absolut mbi vetveten dhe pa asnjë lloj pushteti për vetveten.

Edhe sot e kësaj dite, shumë prej tyre mendojnë se gratë duhet të rrihen nga burrat dhe bashkohen me burrat kundër grave. Elisa tregon se: "Isha bindur se unë isha gjithmonë fajtorë kur më rrihte burri por, nuk e dija se cilat ishin gabimet e mia. Një natë isha shtrirë në krevat dhe po flija. Burri erdhi vonë dhe më rrahu. Mendova me veten time: Mirë herët e tjera, po tani ku e provokova unë atë?"

Në ditët e sotshme, shumë nga gratë e dhunuara provojnë ta gjejnë vetë "rugëzgjdhjen", shitjen e trupit, alkool, drogë por edhe vetëvrasje. Shoqëria heshtë, politika heshtë.

Lekë Imeraj
shkrimtar, përkthyes, publicist

SHENJAT MË TË PËRGJITHSHME TË SARS-COV-2 (COVID-19)

Sipas konkluzioneve të deri tanishme-më shumë se gjysma e rasteve pozitiv me covid-19 kane simptoma digjестive (të aparatit tretës)-bark-diarre-dhimbje gryke, lodhje tej mase, ethe 38°C, here – here shfaqje në lëkure e të tjera.

SHENJAT më të përgjithshme-shenjatat për meshkuj dhe për femra:- rregullat e shfaqjes :-

-rrufe, gjendje gripale-ethe, dhimbje koke, shfaqje në lëkure-shenja nga ana e aparatit tretës –dhimbje barku, tendence për vjellje, diarre, dhimbje gryke--*-humbje nuhatje dhe prishje të shijes, vështirësi në frymëmarrje –ka dhe forma pa shenja (asintomatike) ose me stridor (vështirësi në frymëmarrje) astmatiforme ose me zgjatje të shenjave.

Sipas institutit publik të Francës mbi 53% e personave pozitiv për Covid-19 (10 shtator 2020-Buletini EPIDEMJEOLOGJIK) paraqesin-kolle, ethe, prishje të shijes, të nuhatjes, shfaqje në lëkure, dhimbje koke, shkuarje barku, lodhje ekstreme, simptoma këto më të njohura, por që ndryshojnë nga një person në tjetrin. Megjithatë shpesh mungojnë në 76% të rasteve theksohet nga Shëndeti publik Francez .

Midis simptomave të reja, më të rralla shprehen mjeket francez, është një rrahje e shpeshte e zemrës (takicardi) e pa shpjegueshme, keqësimi i pa pritur, një dëmtim i befasishtëm i gjendjes mendore, rënie e shpejte (e pa pritur) e tensionit të gjakut, piksim i oksigjenimit (SO2 nen 70%), -rrëzime, dridhje.

A janë të njëjta shenjatat e covid-19 si tek meshkujt dhe tek femrat?

Një studim Evropian i Prillit 2020 nga 50 Otojater në mbi 1420 pacient me infeksion të lehte dhe të mesëm të Covid-19 -paraqiten me shpesh-dhimbje koke (70,3%), humbje nuhatje (70,2%, bllokim-hunde (67,8%), kolle (63%), lodhje (63%), dhimbje muskulore (62,5%), rrjedh-je nga hundët (60,1%), prishje shije (54,2%), dhimbje gryke (52,9%), ethja>38 grade është sinjalizues në 45,4% të rasteve.

Autoret e studimit theksojnë se, prevalence e shenjave ndryshon sipas moshës dhe seksit. Midis grupit të pacienteve prej 1420 veta 962 ishin gra (67,7%) dhe meshkuj 459(32,3%)-Pacientet e moshës së re shpesh paraqesin shenja nga ana e sistemit ORL(vesh, hunde, gryke). Në rastet e renda, jep dëmtime në mushkëri, me pneumoni intersticiale dhe insuficiencë respiratorë acute (SARS), insuficiencë renale deri ne vdekje. Periudha e fshehte është nga 24 ore deri 12,5 dite (mesatarisht 6,5 dite) sipas studimit të të dhënave të shumë vendeve të botes. OBSH rekomandon që personat e kontaktit me rastet covid pozitiv të izolohen për

14 dite.

Deri më sot nuk ka mjekim specifik për Covid-19, megjithatë një numër simptomash mund të trajtohen sipas gjendjes klinike. Antibiotiket si për çdo virus nuk veprojnë, pasi ato janë vetëm antibakterial, sido që mund ti përdoren kur infeksionit viral i mbivendosen baktere si koket, klebsiela e të tjera, pasi ulet rezistenca e organizmit. Tani po përdoren nga shumë vende dhe së fundi ka hyr dhe në vendin tonë-Resedevir, ose Avifovir, që ka dhënë efekt premtues.

Nëse ke kaluar Covid-19 dhe janë krijuar antitrupa mbrojtës ndaj tij a ka mundësi të përsëritet për here të dyte? Është frika që disa persona mund të reinfektohen. Studiuesit e universitetit të Nevada kane studiuar rastin e një pacienti, që përsëriti për here të dytë simptomat e Covid-19 dhe qe cilësohet si rast i pare zyrtar, por sipas Neë Jork Times- është përshkruar më pare një rast i Hong* Kong-ut, Rasti i Nevada është një rezi-

mbrojtës të trupit duke iu kamufluuar dhe ikur. Në anën tjetër, kur kalohet lehte një infeksion – covidit-19 prodhohet një përgjigje më e dobët imunitare-dhe mund ti japi shans reinfeksionit thekson Dott. Sandra Kesh Neë-Jork-Në anën tjetër një burim i ri (Alternativ) i virusit me mutacione mund ti shpëtojë sistemit tone mbrojtës -imunita. Pyetje tjetër që shtrohet-a është më i lehte reinfeksioni? Një infeksion (rikthim) sipas të dhënave të deritanishme shoqërohet me shpesh me shenja më të lehta. Pra është me benign (Dr. Sandra Kesh –Neë-Jork)-por varet nga fakti se po të qe një alternative e virusit, me mutacion që bëjnë me agresiv virusin –mund të kemi dhe rendim, deri tani nuk ka një përgjigje të prere (sakte). Deri tani janë në bote mbi 36 milion raste të infektuar me covid-19 dhe mbi 1 milion vdekje sipas të dhënave të Universitetit të Mjekësisë-John Hopkins-theksohet se rikthimi infeksionit (reinfeksioni) do të jete rrallë, sido qe po grumbullohen


Covid-19, por disa persona kalojnë forma më të renda nga të tjerët-kjo për arsye të deficitit të interferon-tip-1 dhe sot jepet interferon sepse e bllokon replikimin e virusit sipas-punime punimeve të botuara ne revistat “Science” dhe “The Lancet”

- Covid-19 dhe ndërlikimet inflamatorë të ngjashme me KAËASAKI në fëmije

Sot në periudhën e hapjes pas pandemisë covid-19 në France, SHBA-e vende të tjera si Anglia po i bien kampionëve së alarmit-për një syndrome inflamaator multiple (Shumëfishtë), që prek fëmijët dhe të rinjtë deri 21 vjeç-(MIS-C) të ngjashëm me Sëmundjen KAËASAKI-në France 125 fëmije në Angli (20 fëmije), --Po ç’ është në fakt –Sëmundja Kaëasaki?-është zbuluar në Japoni nga autori Kaëasaki –gjë për të cilën i është vene emri i tij- në Japoni janë 90 000 raste të përshkruara prej vitesh. - Në përgjithësi preken fëmijët 2 muaj deri 7 vjeç dhe shoqërohet me temperature të larte për 5 dite, njolla në lëkure dhe në mukoza, skuqje syve (konjuktivit), plasaritje të gjuhës, tharje goje, gjëndra të s’ madhuara në qafe ekimoza, në duar e këmbë, po ashtu dhe ënjtje (edema) në këmbë-Ka vështirësi në vënie e diagnozës së sakte, shërohet spontanisht ose me trajtim në 3/4 e rasteve, ka pak kura dhe në 1/4 e rasteve ndërlikohet me preken e artereve të zemrës (coronarit), që çon në vdekje-mjekimi deri tani ka qene aspirine dhe Imunoglobulina për 5 dite.

CDC (Qendra e kontrollit dhe prevenirimit të sëmundjeve) Amerikane e ka pagëzuar si sëmundje e re-Syndromin inflamator multisistemik tek fëmijët (MIS-C) dhe sipas eksperteve ka

shumë mundësi të jete një pasoje e vonë (pas5-6 javësh) e infeksionit nga virusi përgjegjës i Covid-19. Siç u përmend më lart me 14 maj 2020 shëndeti publik francez raportoi 125 raste të këtij syndrome të ngjashëm me Kaëasaki, që prej 1 mars-deri 14 maj 2020 nga fëmijët e shtruar për Covid-19-Agjensia e shëndetit në kontakt me revistën “science-et-avenir” raporton 12% të fëmijëve të shtruar-dhe behet fjale për lidhje me epideminë e Covid-19-Sipas CDC – amerikane kjo, sëmundja si dhe Kaëasaki, ka ethe dhe një infamacion të paktën te dy organeve-me shpesh zemër dhe aparatit tretës-dhe ekimoza në gjymtyre e të tjera në persona nen 21 vjeç, kur janë ekspozua ndaj SARS-CoV-2-sipas të dhënave franceze nga 125 fëmijë me MIS-C-70-paraqiten inflamacion të zemrës (myocardit) dhe në 47 inflamacion të organeve të tjera-sipas Nicolas Gutierrez. C. Një sëmundje që mund të jete e rrallë-‘por e rende. Pra, sipas francezeve është fjala për një ndërlikim pas infeksionit- Co-



dent në Ëashoe, pati test pozitiv për Covid-19 në muajin Prill, pasi u shërua me 2 teste negative-në Qershor 2020, pas 48 ditësh konstatohet përsëri pozitiv testi, pas analizave u përcaktua një mutacion (transformim) i AND-s virale në një reinfeksion. Pas këtyre dy episodeve, shtrohet pyetja-a është frikë për një reinfeksion? Përball dëmeve të provokuara nga covid-19 dhe të valës së dyte të tij, ekspertet shpresojnë së infektimi i popullsisë do të shpërthejë një reaktion imun-mbrojtës, gjë që do të ishte ideale, por nuk duket e sigurve. Dhe covid-19 beri mutacionet e veta-nga stereotipi “D” në fillim sot në 75% te rasteve kemi stereotipin “G”-sepse në të kundërt do të ishte i vetmi virus në botë që nuk bën mutacione, gjë që është e pamundur, që në nisje. Reinfektimi ndodh kur sistemi imun i trupit rilashohet, ç’ tensionohet në muajt pasus të kontaminimit. Vete mutacioni i virusit duke kaluar sa në një organizëm në tjetrin mund të mashtror sistemin imun-mbrojtës dhe ti shpëtoj zbulimit, pra i shmanget forcave

të dhënat në grup më të madh njerëzish.

Vaksina anti gripale e bërë çdo vit ka qene premtues.çdo vaksine ka si qellim të nxisë organizmin të prodhojë antitrupa mbrojtës specifik ndaj një agjenti infektiv rrezikues, -në mënyre që kur bie në kontakt me këtë agjent është në gjendje të reagojë pozitivisht sistemi imunitar mbrojtës-kjo mbrojtje mendohet se është e qëndrueshme nga 4 muaj deri në 1 vit, nëse reagon si viruse të tjerë. Kështu po punohet nga shumë firma prestigjioze si-Astra-zeneta, Sannofi dhe se fundi firma Ruse “Sutnik-V”. Kështu shumë prej tyre kane kryer provat e 1 dhe 2 me sukses, Firma Ruse-“Sputnik-V” raportoi me entuziazëm të madh provat 1 e 2 të sukseshme gjë që u botua dhe në revistën mjekësorë “The Lancet”, ku theksohet se vaksina jep përgjigje mbrojtës dhe pa efekte anësorë, tani ka filluar faza 3 në një kontingjent prej 40 000 personash, ku shpresohet të mos ketë efekte anësorë as në fazën e 3. Siç u shpreh ka rrezik për përsëritje për here të dyte të infeksionit-

vid-19 të takuar 4-6 jave më vonë-në një numër fëmijësh-ku nga 125 (90 prej tyre në gjendje të rende-65 në shërbim reanimacioni, ku 25 në gjendje kritike për jetën, të intubuar-prej një totali 207 fëmijësh të shtruar-(ka vdekur vetëm 1 fëmijë 9 vjeçar seksit mashkull)-që kishte dhe sëmundje shoqërues të zhvillimit të vonuar mendor). Sipas të dhënave nga 20-26 Prill, 2 jave pas pikut të Covid-19 kemi shtruar 35 fëmijë –më vonë numri i rasteve është ulur në mënyre të ndjeshme me 7 raste nga 4-10 maj. Po ashtu dhe në Angli janë shfaqur rastet e para në fund të prillit. Nga 100 raste të raportuara në SHBA (3 vdekje). Pra, kësaj tërhiqet vëmendja e profesionistëve për raste nën 21 vjeç me ethe, inflamacion me vështirësi për tu diagnostikuar dhe ka dhe shenja të ngjashme me Kaëasaki-siç u përshkrua në fillim të këtij shkrimi. Sipas CDC-hipoteza e kësaj sëmundje duhet të hedhet për të gjitha rastet e fëmijëve të kontaktuar me SARS-CoV-2-ku duket se ndërhyr me këtë sëmundje 4-6 jave pas kontaktimit, ku tashme janë zhvilluar antikorpe-. Sipas Sunil Sood-qendra mjekësore e femijve -Cohen-Neë-York- fëmijët kishin virusin-kane luftuar me te, tani kemi këtë përgjigje të forcave imunitare-mbrojtës ekseseve –shprehet ajo. -Disa autor supozojnë se kjo ka arsye gjenetike,

por mendimi dominues është për lidhje me Covid-19-.

Cilat janë pistat e ilaçeve kundër Covid-19?

Clorakina një ilaç i njohur kundër Malariae (antimalarik) Prof. Didier Raoult -Infexionist në Marsseille- çfarë efikasiteti realizoj në vijim 3 studime me një fare efikasiteti me (HCQ)-hydroxicloroquine-por rezultatet e marra janë vene në dyshim nga një studim me 22 Maj 2020 nga revista "The Lancet" autori analizoi apriori 96 000 pacient me Covid-19 te 671 spitaleve nga 20 Dhjetor 2019 deri 14 Prill 2020-14 888 prej tyre kane bere 4 kombinime të ndryshme-klorakine, Hydroxiclorakin trajtimet ishin bere të veçuara ose të kombinuara me antibiotikë të familjes se makrolideve si Azytromycin-Në fund krahasimi me grupet e kontrollit-dëshmi u bë me 81 000 pacient. Duke marre të dhënat statistikore të vdekshmërisë sipas grupit të ilaçeve të përdorura ishte 34-45% më i larte se grupi i krahasuar dëshmi. Për më tepër rreziku i aritmisë ishte 5 here më i lartë. Ekipi i kërkimeve kolaudoj se nuk ka përfitime në mase as nga hydroxicloraina as nga chlorakina, qoftë të veçuara apo ne kombinim me macrolide (azytromycin). Klorakina dhe hydroxiclorakina janë pezulluar nga provat klinike-nga agjen-

cia kombëtare e sigurisë së barnave dhe këshilli i larte i shëndetit publik (HCSP), në solidaritetin me OMS-in. Prof. Raoult, publikoi një studim të ri, që refuzon tezen e përçmimit- "Ne raportojmë në mënyre retrospective 3737 pacient nga të cilët 3054 (81,7%) janë trajtuar me hydroxiclorakine dhe Azytromycini 025 për të paktën 3 dite dhe 683 janë trajtuar me metoda të tjera. Niveli i mortalitetit ishte 0,9%- asnjë efekt anësor cardio-vascular- nuk është shënuar –pra ka dhënë një rezultat klinik të mirë-po ashtu mjek terapeut kane shoqëruar këtë mjekim me vit. C+Mg+Zn. Dr. Gostaldi referon rritjen e efektivitetit në mënyre empirike.- te Vit>C. Mg. Zn. tek të sëmuret astmatik.-si dhe anti-inflamator në pneumoni inersticiale.-dhe në format e renda heparin në doza të vogla për të parandaluar trombozat dhe flebitet, embolin pulmonare, -si ndërlikime të shpeshta të coronavirusit. Fillimi sa më i hershem i mjekimit jep rezultate inkurajues. Prej disa javësh është përshkruar ky trajtim në pacient me Covid-19-në më tepër se 200 pacient-dhe vetëm 2 raste kane qene në gjendje të rende dhe kenë vdekur, 40 janë trajtuar në spital-azytromycina është përdorur prej vitesh në fëmijë dhe të rritur pa efekte anësore –s'ka asnjë arsye të privohet, që në shenjat e para. Këto rezul-

tate megjithatë mbeten fraxhile-nuk behet fjale për një studim multicentrik dhe të randomizuar.

Sfida madhore për vaksinën dhe mjekimin kundër covid-19

Disa patron të industrisë farmaceutike sjellin shpresa për një vaksine deri në fund vitit 2020. Sido që dyshimet për kapacitetet prodhues qëndrojnë. Por shpresat për të pasur një vaksine shume shpejt sipas Paskal Soriot –"Astra Zeneta" et Albert Bourla: "Pfizer" nëse gjithçka shkon sipas parashikimeve kemi një drite jeshile.-ka një yll ndriçues) më së fundi ka mjaft prova efikase dhe të sigurta për të arritur të kemi një ose disa vaksina deri nga fundi i vitit 2020 ose fillimi i viti 2021. -Federata ndërkombëtare e industrisë së ilaçeve (IFPMA) jep një shprese qetësues, ku llogariten se nevojiten 15 miliard doza vaksine për popullatën botërore, gjë që paraqet një sfide qofte për prodhimin dhe shpërndarjen. Sido që ka prova për uljen e nivelit të transmetimit të virusit.

Përgatitur nga

Dr. Med. Ndue NIKAJ,
Patholog-Internist (Shkodër)

FAMIJA NË UDHËKRYQ

Të dashur lexues duke parë dhe dëgjuar mbi aktualitetin e familjes sot mendova që nëpërmjet një cikli, të sjellë disa mendime në lidhje me këtë temë mjaft të rëndësishme.

Mundësitë edukative të veçanta të familjes dhe parakushtet themelore të edukimit familjar.

Detyra dhe përbajtja e edukatës familjare

Metodat dhe mjetet e edukimit në familje

Bashkëpunimi i familjes dhe i faktorëve tjerë edukativ

Natyra e bashkësisë familjare është ajo forca, ai autoriteti, prej nga rrezatojnë mundësi të ndikimeve shumë të forta edukative.

Dashuria prindërore për fëmijët, si dhe dashuria e ndërsjellët e prindërve dhe e fëmijëve përbëjnë në vetvete forcën e ndikimit edukativ. Dashuria është lëvizëse jo vetëm e prindërve lidhur me kujdesin e tyre vetëmohuese e të pakufishëm për fëmijë, po edhe i fëmijëve që të përmbushin kërkesat e prindërve të vet, që të përqafojnë rregullat e ndryshme të jetesës, qofshin ato edhe një farë dhune e caktuar ndaj personalitetit, qofshin edhe ato që e kapërcejnë kufirin e arsyes dhe përvojës së jetës.

Mundësitë e veprimit edukativ të familjes janë të mëdha edhe për shkak të faktit, se një pjesë të jetës së vet fëmija e çon në rrethin familjar. Meqenëse fëmijëria sociale sot zgjatë më shumë se përpara, i riu i shtrohet një kohe vërtet të gjatë ndikimi të fortë të familjes, që në thelb ka funksion edukativ.

Forca e edukimit familjar del nga fakti se fëmijët gjenden nën ndikimin e tij në moshën e re, në kohën kur u shtrohen më

së lehti ndikimeve edukative. Në këtë moshë jo vetëm arrihen lehtë përvojat dhe diturit e para, po vihen edhe themelet e cilësive më të rëndësishme të personalitetit.

Mundësi të mëdha të edukimit familjar gjenden edhe në ndjenjën e përgjegjësisë shoqërore të prindërve për zhvillimin e fëmijëve, për rezultatet e edukimit dhe për të ardhmen e fëmijëve. Kjo ndjenjë familje duhet të jetë një shtytje e fuqishme për prindërit në veprimin aktiv të përkujdesjes lidhur me edukimin e fëmijëve.

Të gjitha këto mundësi, pothuaj të ndryshme të familjes, për një edukim të suksesshëm të fëmijëve, do t'i ndërtoj familja vetëm në qoftë se në mënyrën e jetesës së familjes ekzistojnë kushte themelore për edukimin familjar, nga të cilat do të përmendim vetëm disa.

Struktura e drejtë e familjes, që do të thotë familja e plotë dhe e harmonizuar, kushti themelor pozitiv për edukim të mirë në familje. Në familje të plotë gjenden mundësitë themelore të rrethanave të volitshme familjare, sepse çdo anëtarë i familjes e ka vendin e vet të caktuar. Kjo, më

tutje është kusht për marrëdhënie të shëndetshme nëpërmjet anëtarëve të familjes, që paraqet gjithsesi burim të ndjenjës së sigurisë së fëmijës. Ndjenja e sigurisë në familje është një nevojë e fuqishme shoqërore, e cila familje jo vetëm është kusht për shëndetin shpirtëror të fëmijës, po familje njëkohësisht edhe bazë për forcat e veta, vetëdijesia, guximi, optimizmi dhe karakteri i fortë, përkundër shpirtngurtësisë, zbrapsjes apo agresivitetit- si shprehjet më të shpeshta të ndjenjës së pasigurisë.

Dukurit të ndryshme negative në familje, si p.sh., kriminaliteti, alkoolizmi, moskujdesi për fëmijët dhe papjekuri e prindërve, papjekuri shoqërore, shkalla e ultë e kulturës. Problemet e rënda të edukimit dhe pengesat në zhvillimin e fëmijëve e të rinjve, që rezultojnë nga papjekuria e prindërve, janë rëndom pasoja të këtyre gabimeve:

Të dashurisë së verbër të prindërve, prej nga rrjedh iltimi, arroganca, bile edhe paturpësia, si mungesë e ndjenjës për njerëzit e tjerë:

Të rreptësisë e të ashpërsisë së tepërt të prindërve, prej nga rrjedhin konflikte



të shpeshta, frikë, gënjeshtër, mbyllja në vetvete, të metat në të folur.

Të ambicieve të prindërve, të cilët jetën e familjes së vet e konsiderojnë si vazhdim të jetës së tyre dhe si mundësi për të realizuar ideat e tyre të paarritshme.

Të mbështetjes së prindërve mbi pushtetin e tyre prindëror si autorizim shoqëror në vend se të veprojnë me atë të autoritetit të vërtetë që e krijojnë prindërit me shembullin vetjak, me besimin e fituar dhe me mësimin që u japin

Pozita e fëmijës në familje është faktor i rëndësishëm për edukimin e suksesshëm të fëmijëve. Fëmija i dëshiruar dhe i pritur me padurim, që pranohet ndershmërisht në gjirin familjar nga ana e prindërve, u shtrohet më lehtë përpjekjeve pozitive të prindërve. Përkundrazi, fëmija i padëshiruar, i tepërt prej të cilit janë të tjetërsua emocionalisht prindërit, familje faktor i papërshtatshëm për edukim familjar.

Organizimi i jetës së familjes, do të thotë caktimi i regjimit të caktuar, i rendit dhe i rregullimit në shtëpi, pastaj organizimi i detyrave të fëmijëve në familje-janë pjesë e rëndësishme e punës së prindërve. Këto "imteshi" e rregullojnë jetesën në familje, caktojnë vendin e fëmijës në familje; si dhe marrëdhëniet e ndërsjella të anëtarëve të saj. Prindërit që kanë arritur të organizojnë mirë jetën në familje, kanë krijuar një kusht thelbësor për punë edukative në familje duke kuptuar që thelbi i kësaj pune qëndron të shpeshtën në ndikimin e tërthortë edukativ të fëmijës.

Fëmijës nuk i mjafton krijimi i kushte... (të këtë për të ngenë, veshur e shkolluar e të tjera) Përkundrazi sot vërehet në shumë raste tejkalimi i nevojave bazë dhe kjo sjell "llastimin", largimin nga realitet dhe përjashtimin e adoleshentit dhe të riut nga realiteti. Nga statistikat vërehet se në shumë raste kurë fëmijët janë të mbështjell më gjitha të mirat e tepruara ja më të rrishtuar të mos mësojnë, të mos angazhohen me jetën dhe për jetën dhe si pasojë ato janë viktima e parë e rrugës.....

(vijon)

Përgatiti Roza Pjetri

SHOSHI HUMBI DY BURRA TË NDERUAR TË TIJ

Fshati Ndreaj humbi dy bij, nga më të mirët që kishte.

E ndej për obligim dhe detyrë që të shkruaj pak rreshta për dy burra të njohur e të nderuar të fshatit Ndreaj, Shoshi, që vdekja i ndau nga ne, në ditët e fundit të shtatorit 2020, Mhill Lulash Gjeloşi dhe Nikoll Prek Bregu.

Të dy shokë dhe pothuajse moshatar me njëri-tjetrin, të nderuar të një gjaku dhe të një fisi.

Pavarësisht se vinin nga familje të ndryshme dhe ndoshta, kishin përkatësi politike ekstremisht të kundërta, përsëri ata ishin shokë të ngushtë me njëri-tjetrin.

Njëri vdiq në Shkodër dhe tjetri në Amerikë, në ditët e festes së shenjtit Shën Mhilli.

Për ata, që nuk i kanë njohur, po mundohem shkurtimisht t'u përcjellë disa të dhëna për këta burra.



Mhill Lulash Gjeloşi, ishte i biri i të ndjerit Lulash Gjeloşi të Shoshit, një nga burrat më të zgjuar që ka pasur Shoshi, luftëtar dhe prijësi i parë i Shoshit në beteja të ndryshme për mbrojtjen e atdheut.

Ai ishte vëllai i të ndjerit Gjeloşi Lulashi, Martirit të Kishës Katolike dhe kandidat për shenjterim mes 38 martiret e Kishës, i cili u vra nga regjimi Komunist në Shkodër në vitin 1946, së bashku me 7 Jezuit të tjerë dhe i vëllai i të ndjerit Ded Lulashi të Shoshit.

Për sa i përket familjes së Mhill Lulashit, nuk dua të zgjatem, sepse ajo tashmë është pjesë e njohur nga te gjithë, si një e pjesë e Historisë së Shqipërisë, pasi burrat e kësaj dëre, ishin prijësit e Shoshit në çdo e luftë dhe betejë, që Fisi i Shoshit

ka bërë për mbrojtjen e trojeve tona. Me 14 të pushkatuar nga regjimi komunist dhe me lidhje shumë të forta që kishte me fisin e Shoshit brez pas brezi.

Sot, shkurtimisht po shkruaj për Mhill Lulashin. Mhill Lulashi u rrit fatkeqësisht në fillimet e regjimit komunist, ku atij iu vranë familjaret dhe u internuan gjithë familja, iu dogj kulla dhe iu sekuestrua e gjithë pasuria. Vitet e para të fëmijërisë i kaloi në internim, në kampin famëkeq të Tepelenës dhe u kthye në vendlindje pas disa vitesh. Me shumë vajtje dhe mundime u rrit nën kujdesin e nënës së tij të nderuar, z. Mire Vuksanja, një grua shumë e zonja, burrnore dhe e njohur në gjithë Dukagjin. Kolektivizimi e gjeti të martuar me një grua zonje me të tana cilësitë e një gruaje malësore, e bija e të ndjerit Sokol Prela nga Pjolla. Ai punoj gjatë gjithë kësaj kohe si mjeshtrë kryesor në të gjitha ndërtimet, që u kryen në kooperativën e Shoshit për 25 vjet, aty ku ishin ndërtimet ma cilësore në Shosh. Këtë punë e kreu me shumë cilësi dhe puna e tij nuk kishte të kontestime. A ishte mjeshtri kryesor i motor sharrës së kooperativës në Shosh, që disa herë e larguan nga Shoshi, por përsëri kthyen, sepse ishte i pazëvendësueshëm në punën e tij. Shoshi e njohu si krye mjeshtrë.

Nuk ka pasur asnjë shpi në Shosh që nuk ka pasur diçka nga duart e tij, duke nisur nga gjerat e vogla që i shërbejnë një familjeje, deri tek më e madhja, si: karrige, tavolina, korniza, tavane, dysheme, derë, dritare, deri edhe zbulurime, sidomos në dhomat e çifteve të martuar duke ua mobiluar dhomën.

Pra, të gjithë e kanë njohur fjale pak e punë shumë, pak i vrenjtur në pamje të parë, por shumë i sinqertë, korrekt, shpirt mirë, fisnik dhe besimtar i devotshëm.

Fundi i jetës i erdhi mjaft i mirë. Jo në vuajtje skamje e mjerim. Ai la mbrapa një familje të mrekullueshme, me gruan Zoje, me një djalë nga më të mirët në Shosh, dhe katër vajza, të gjithë të martuara dhe me familjet e tyre të mrekullueshme, me plot nipa e mesa shpije dhe bije.

Gëzimin dhe dashurine më të madhe e kishte për djemtë e djalit të tij, që i ka si drita, i ka rritur me duart e tij, me edukatën dhe kulturën e tij.

Ai ndërroj jetë natën e emrit të tij, natën e Shën Mhillit, në një ditë të shenjtë ashtu siç ishte edhe vet një njeri shumë besimtar.

Ai ishte një familjar i shkëlqyer, punë-

tor duarartë dhe shok i mirë.

Mhilli u varros në varrezat e Rmajvet, me datë 29 shtator 2020 me shumë nderime. Edhe pse ishte kohe epidemie, pjesëmarrja ishte shumë e madhe.

U prehtë në paqe shpirti i tij!



Nikoll Prek Bregu, ishte edhe ky nga fshati Ndreaj Shosh, kushëri dhe shok me Mhillin. Me një temperament ndryshe nga Mhilli në pamje të parë. Ishte më i qeshur e më hokatar, orator dhe shumë komunikues.

Ishte person i shoqërueshëm dhe kjo e ndihmoi që fëmijë dhe po ashtu, si shpi e kohës që ishte dhe nuk kishte mbi shpinë persekutim komunist. Ai lindi dhe u rrit në një familje të nderuar të Shoshit dhe që njihej si shpi fisnike punëtore dhe shumë bujare.

Ishte vllai i vogël në katër djemtë e Prek Sokolit nga Ndreaj Shosh. U rrit dhe u shkollua me shumë halle si të gjithë ne, por një djalë shembullor i Shoshit. Ai filloj punë si Veteriner në kooperativën e Shoshit, punoj në arsim disa vite ku u dallua si një mësues shembullor dhe i përkushtuar. Më vonë punoj në sektorin e tregtisë, në Breg të lumit të Shalës, në detyrën përgjegjësi i konsumit dhe beri shumë miq e shokë me sjelljen e tij. Ai i ngjiti shkallet në Shosh deri sa në fund arriti të jetë sekretar i Byrosë së Partisë për Shoshin. Edhe në këtë detyrë, ai ja rriti vlerat vetes dhe Shoshit. Ai i ngjiti shkallet një nga një me sjellje, me punë dhe askush nuk i dhuroj asgjë të pameri-

tuar. Nikolla, detyrën Sekretarit të Byrosë, nuk e bëri sipas vijës së partisë, pasi ishte më shumë në anën e popullit se të partisë, ndaj edhe partia nuk e shpërbleu me lavde as me dekorata, por vlerësimin ia dha gjithmonë vendlindja e tij, Shoshi. Ai tregoj më tepër devotshmëri për Shoshin sesa për vijën e partisë. Ai ishte shumë i komunikueshëm me njerëzit dhe nuk beri kundërshtar edhe pse ishte në një pozicion që ia kërkonte puna.

Me ardhjen e demokracisë ai mbajti një qëndrim mjaft serioz.

Nuk u ankua dhe asnjëherë nuk u mburrë.

Pas ardhjes së demokracisë ai u shpërngul nga Shoshi dhe u vendos në Shkodër dhe mbajti një qëndrim shumë korrekt ndaj ndryshimeve që solli koha. Me kalimin e viteve emigroj në Amerikë (SHBA) së bashku me familje, ku ndërtoi jetën si shumë shqiptar atje, me mund dhe me djersë.

Rriti fëmijë të edukuar bashkë me gruan e tij të nderuar, znj. Marije, por sëmundja e mudi dhe vdekja e mori para kohe në ditët e fund shtatorit 2020. Ai u soll nga Amerika dhe u varros në Shkodër, me datën 11 tetor 2020, me shumë respekt dhe nderime.

Edhe pse ishte epidemia Covid-19 pjesëmarrja në ceremoninë mortore ishte shumë e madhe.

Shpirti i tij, u prehtë në paqe!

Së fundi, dua të them se këta dy burra të Shoshit ishin nga një katund nga një fis. Ishin shumë shokë pavarësisht përkatësisë politike dhe qëndrimeve diametralisht të kundërta. Ata mbeten model i bashkëjetesës politike, sepse tjetër është politika dhe tjetër shoqëria. Ata vdiqën në një kohë sikur ta kishin bërë me një fjalë dhe Shoshi i nderoj pa dallim.

Ndaj edhe ne s'kemi pse ti veçojmë në asnjë gjë, pasi vdekja i mori bashkë.

Edhe unë e ndjeva për detyrë të shkruaj pak, pasi për të pasqyruar jetën dhe veprën e këtyre burrave.

Të gjithë një ditë do të shkojmë nga kjo jetë

Vetëm fjalën dhe veprën do lamë pas.

Asgjë s'do marrim me vete!

Respekt dhe mirënjohje për ta!

U prehshin në paqe!

Përgatitur nga
Gjon Kosteri

Atletika shqiptare në zi!

NDAHET NGA JETA NË MOSHËN 75 VJEÇARË, MJESHTRI I MADH, VILDAN TUFI

Sporti shkodran dhe në veçanti atletika po humb një e nga një kolosët e tij, ato të cilët i kanë dhënë nder dhe lavdi këtij qyteti të lashtë e plot traditë ku krahas fushave të tjera padyshim që është krenuar me arritjet që ka pasur në vite. Pas Gëzim Memes, një tjetër emër potent, atlet, trajner dhe drejtues i aftë për shumë vite i sportit shkodran, komunitetit të sportit të qytetit verior dhe i është shkëputur edhe një figurë tjetër shumë

e njohur. Bëhet fjalë për Vildan Tufin, Mjeshtrin e Madh të atletikes shkodrane dhe asaj shqiptare, zemra e të cilit pushoi mëngjesin e së dielës së 18 tetorit 2020 në moshën 75 vjeçare. Një lajm ky që padyshim ka tronditur të gjithë botën e sportit, e sidomos Shkodrën aty ku ai u lind dhe u rrit duke pasur një karriere tejet të pasur, jo vetëm në sport por edhe në botën akademike pasi siç dihet ai ishte pedagog dhe themelues i departamentit të

edukimit fizik dhe sportit pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër. Pjesë e një familje sportive shkodrane, Vili siç njihej nga komuniteti i Shkodrës dhe më gjere, shumë shpejt, që në rini do të lidhej me sportin e atletikes duke u inkuadruar në ekipet e Vllaznisë si pjesë e garave të vrapimeve, ndërkohë që më pas tërheq vëmendjen edhe në kërcimin me shkop ndër të vetmit në Shkodër që e ka aplikuar një disiplinë të tillë. Sukseseve si sportist,

Vildan Tufit do t'i bashkëngjiten në vijim edhe ato si trajner. Madje, në cilësinë e trajnerit Vildan Tufi do të mbahet mend gjatë, pasi sportistët që dolën nga dora e tij, si Vera Bregu, dhe Arbana Xhani, Admir Bregu dhe Izmir Smajli, etj mbërritën në majat më të larta të atletikes shqiptare e më tej si kampionë dhe rekordmenë absolutë të garave të kërcimit së gjati deri edhe në cilësinë e kampionit të Evropës siç është rasti i Izmir Smajlajt. Kampionia e radhës që profesor Tufi po përgatiste gjatë periudhës së fundit ishte një tjetër vajzë e talentuar Erisa Rrasa, që ai shpesh herë ai preferonte ta konsideronte si një Vera Bregu e dytë, me të cilën falë talentit

të saj dhe punës profesionale të vete profesorit, kishte objektiv të shkonte shumë lart në rezultate, madje për t'ia kaluar edhe vete Vera Bregut. Si sportist, trajner, si pedagog dhe drejtuesi i departamentit të edukimit fizik në Universitetin Luigj Gurakuqi, dhe qytetar i nderuar i Shkodrës, Vildan Tufi është vlerësuar me dekorata të ndryshme nga klubi Vllaznia, Bashkia Shkodër, Universiteti Luigj Gurakuqi, Federata Shqiptare e Atletikes, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, për të mbërritur në titullin e fundit "Mjeshtër i Madh" akorduar nga presidenti i Republikës Ilir Meta. Me ndarjen e tij nga jeta, atletika shkodrane dhe ajo shqiptare humbi profesionistin, universiteti pedagogun e aftë, Shkodra qytetarin model dhe familja bashkëshortin dhe prindin shembullor.

Përcjellja

Vildan Tufi meritonte një ceremoni zyrtare me homazhe dhe nderime në mjediset publike të qeverisjes vendore, pse jo edhe në stadiumin "Loro Boriçi", aty ku ai kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij sportive. Dhe realisht për këtë strukturat përkatëse, SK Vllaznia dhe Bashkia Shkodër kishte marrë të gjitha masat e duhura për një gjë të tillë, por situata e Covid-19 që në Shkodër duket se është prezent me përmasa të mëdha e bëri të pamundur një gjë të tillë. Por, kjo nuk e pengoi në asnjë mënyrë komunitetin shkodran t'i bënte respektin e duhur kësaj figure të nderuar të sportit shkodran dhe më gjere që krahas Vllaznisë ka kontribuar si sportist edhe me Klubin Sportiv Partizani dhe kombëtaren kuqez, ndër kohë që një vlerë më vete është edhe periudha si trajner i dalluar i Vllaznisë dhe kombëtares shqiptare duke mos lënë mënjane edhe kontributet në fushën e arsimit si pedagog dhe drejtues i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës. Kampionët përcillen me duartrokitje dhe ashtu u përcoll edhe Vildan Tufi në momentin kur arkivoli me trupin e tij të pa jete po dilte nga banesa private e familjes "Tufi" për t'iu drejtuar varrezave publike të qytetit. Mes turmës së madhe që shoqëronte kortezhin spikasnin njerëzit e sportit, nxënësit dhe kolegët e profesor Tufit në vite, si veterani i peshëngritjes Faruk Kalleshi, bashkëkohës me Tufin tek Vllaznia dhe Partizani, Angelina Gurakuqi, Nexhmije Bilali, Isak Bala, Albert Marashi, kampioni i



Evropës Izmir Smajlaj, etj. Në këtë ditë lamtumirë për profesorin e madh Vildan Tufi nuk mund të mungonte edhe kreu i Federatës Shqiptare të Atletikes Gjergj Ruli, ai i cili e vizitoi edhe pak ditë parë përpara se të ndërronte jete, i cili në fjalën e tij të lamtumirës vlerëson maksimalisht figurën e Profesor Doktor, Vildan Tufit.

Ngushëllimet e autoriteteve

Ilir Meta-President i Republikës së Shqipërisë – "Me shumë dhimbje mora lajmin e trishtë për ndarjen nga jeta të Mjeshtër të Madh, Profesor Vildan Tufit, personalitetit të shquar dhe të padiskutueshëm të sportit shkodran dhe kombëtar. Humbje shumë e madhe dhe e pazëvendësueshme për familjen e Tij dhe thëllësisht pikëluese për mbarë komunitetin e atletëve shqiptarë, që ndahen sot nga ky kolos i sportit shqiptar që la gjurmë të mëdha, si atlet rekordmen dhe trajner i kampionëve të mëdhenj, veçanërisht në garat e kërcimit së gjati, trehapësh, garat e shpejtësisë dhe 10-garësh. Pasioni dhe profesionalizmi i tij do të mbeten një shembull i çmuar dhe frymëzues në përgatitjen dinjitoze të atletëve elitare dhe kampionëve të ardhshëm të atletikës tonë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si Izmir Smajlaj, Vera Bregu e Admir Bregu. Me mirënjohje e respekt do ta kujtojmë Profesor Tu-

fin për punën e palodhur në edukimin e brezit të ri, me dashurinë për sportin, larg rreziqeve sociale dhe veseve. Familjes Tufi, atletëve, bashkëpunëtorëve, miqve dhe mbarë komunitetit të dashur të Shkodrës ju shpreh ngushëllimet më të ndjera për këtë humbje që na tronditi sot të gjithëve! I paharruar kujtimi i Profesorit Vildan Tufi! U prehtë në paqe!"

Voltana Ademi-Kryetare e Bashkisë Shkodër- "Sapo mësova një lajm të trishtueshëm, Profesor Vildan Tufi, është ndarë nga jeta! Një humbje e madhe për sportin shkodran e shqiptar, për atletikën shkodrane e shqiptare. Trajner i palodhur i kampionëve, edukator shembullor dhe prind e familjar si ai. E prisnim të gjithë që të kthehej në pistat e atletikës, e prisnim që të fitonte betejën me sëmundjen e rëndë! Fatkeqësisht nuk ia doli, për tu larguar nga kjo jetë vetëm fizikisht. Profesor Vildan Tufi do te jetojë përmes kampionëve të panumërt që stërviti, titujve e medaljeve që përmes punës së tij, i solli në Shkodër. Pushofsh në paqe Profesor Vili! Do të na mungosh!"

Majlinda Angoni- Prefekte e Shkodrës – "I trishtë lajmi për vdekjen e legjendës së atletikës së Shqipërisë "Mjeshtër i Madh", Vildan Tufi. Prof. Vilin do ta kujtojmë si një njeri i madh, një jetë shkrirë në sport, besnik i pasionit të tij deri në frymën e fundit, fitues i të gjithë betejave, frymëzim për shumë breza sportistësh të Shqipërisë dhe ikonë e atletikës. Pasioni dhe profesionalizmi i tij do të mbeten një vlerë e çmuar për brezat e ardhshëm në sportin e atletikës. Sot sportistët e Vllaznisë dhe të gjithë Shqipërisë janë në zi. Ngushëllime të sinqerta familjes Tufi dhe gjithë të afërmeve dhe miqve të tij. Ngushëllime Shkodër!"

Brisela Truma Kadija-Kryetare e Këshillit Bashkiak Shkodër- "Një tjetër figurë e shquar e Shkodrës, dhe jo vetëm, sot është ndarë nga jeta. Sportisti, trajneri e pedagogu Vildan Tufi nuk është më. Këshilli Bashkiak i Shkodrës i shpreh ngushëllime familjes dhe komunitetit të sportistëve, veçanërisht atletëve, për këtë humbje të madhe. Vildan Tufi gjithë jetën kontribuoi maksimalisht për sportin në përgjithësi dhe atletikën në veçanti, tek Vllaznia dhe ekipi kombëtar. Sportistë rekordmenë atletike në Shqipëri dhe jashtë saj, me vite kanë pasur udhëheqës e trajner Vildan Tufin, puna e të cilit ka qenë me rezultate të prekshme. Kontribut

të madh profesor Vildani dha dhe në përgatitjen e mësuesve të edukimit fizik si pedagog e drejtues në degën përkatëse në Universitetin e Shkodrës, që në fillimin e funksionimit të tij. Prof. Vildani ka një vend të nderuar në sportin shkodran e kombëtar. Vdekja e tij është humbje jo vetëm për familjen, miqtë e shokët për Shkodrën dhe sportin shqiptar. Të qofte dheu i lehtë mjeshtër. Me punën tënde ke siguruar pavdekësinë. Do kujtohesh gjithmonë!"

Viron Bezhani-President i KOKSH- "Kjo e diele solli lajmin e trishtë të ndarjes nga jeta të profesor Vildan Tufit, një prej trajnerëve më të shquar të sportit shqiptar dhe veçanërisht atij të atletikës, një ikonë e këtij sporti. Ai ia ka dedikuar të gjithë jetën e tij sportit të "mbretëreshës" dhe falë përkushtimit të tij janë të shumtë kampionët e atletikës që janë stërvitur prej tij. Madje shumë prej tyre janë rekordmenë e modelistë. Një njeri që asnjëherë nuk iu nda pistës së atletikës, ku prej punës së tij u formuan mjaft atletë, që sot nuk do të kenë më pranë trajnerin dhe mësuesin e tyre. Ndaj, ndarja e parakohshme nga jeta e Vilda Tufit është një lajm i trishtë për të gjithë atletikën dhe sportin shqiptar. Vildan Tufi me të drejtë konsiderohet si një legjendë e atletikës shqiptare, një njeri që lë një boshllëk të madh me largimin e tij, pasi përvoja e tij ishte një thesar i çmuar për atletikën shqiptare. Si president i KOKSH ndjej një keqardhje të madhe për këtë lamtumirë të profesor Vildan Tufit, mikut tim, duke i shprehur ngushëllimet më të sinqerta familjes."

Gjergj Ruli-President i Federatës Shqiptare të Atletikes- "Atletika sot është në Zi! Një nga kalorësit e saj Mjeshtëri i madh i Punës, njeriu që dhuroj shprese tek Rinia Shkodrane dhe te ajo kombëtare sot mbylli sytë nga një sëmundje tej e lodhshme. Vepra dhe kujtesa ne Sportin Shqiptar do te mbetet ne Arkivat e çdo sportdashësi. Ai që ka lënë një gjurmë të pashlyeshme në zemrat e tona, ai do të jetë gjithmonë i qeshur dhe plot jetë në kujtesën tonë.

Përulëm me dhimbje për para një kolosit si Vildan Tufi.

U prehtë në paqe Mjeshtër i Madh!"

Mjeshtër i Madh, Vildan Tufi

Përgatiti

Gaspër MARKU

NDAHET NGA JETA SPECIALISTI I NJOHUR I BUJQËSISË, THEMELUESI I PERIMEKULTURËS SHQIPTARE, TOFIK FUGARINI.

Është ndare sot, në moshën 72 vjeçare specialisti i njohur i bujqësisë, themeluesi i Perimekulturës Shqiptare, Tofik Fugarini. Ka lindur në vitin 1948, në fshatin Kuç të Shkodrës. Është diplomuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës në vitin 1971 dhe pas diplomimit punoi agronom në kooperativat bujqësore të rrethit Puke, Postribe dhe drejtor në fermën bujqësore.

Në vitin 1993-1997 ishte këshilltar për programin PHARE.

Në vitin 1997-2003 ka drejtuar projektet e Perimekulturës në Shqipëri, në kuadrin e organizatës humanitare Oxfam. Unë kam pasur fatin të jem një nder bashkëpunëtorët më të afërt të tij së bashku me Rita Çunin e Tom Ndoken. Gjate drejtimit të programeve të perimekulturës është bere e mundur ngritja e Qendrës së perimekulturës në Ganjolle të Shkodrës. U realizua botimi i mjaftë broshurave për perimekulturën si dhe finalizimi i botimit të gazetës "Perimekultura".

Tofiku ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ndihme të fermerëve të zonave malore e të varfëra në Shalë, Shosh, Pult, Postribe, Shllak, Temal, Vig-Mndel, Hajmel në trajnimin dhe financimin e projekteve të perimekulturës (bujqësia e qëndrueshme).

Jeta e tij u karakterizua nga humaniz-



mi njerëzor në shpërndarjen e njohurive për njerëzit që punonin në fermat e tyre bujqësore. Gjendet për shumë vite nga fshati Likaj- Postribe deri në Serme të Toplanes me një përkushtim të madhe të njerëzve, duke organizuar trajnime me fermerë e sjelle specialiste nga vendi e bota e jashtme. Deri në vitin 2010, punon për shtrirjen e perimekulturës në të gjitha zonat e Qarkut të Shkodrës. Është

njohës i shkëlqyer i metodave të perimekulturës aq të përshtatshme për kushtet e fermerëve shqiptare. Duke qene një nder specialistet më të mirë të bujqësisë ishte i ftuar në shumë vende për kumtesë e seminare. Përfaqësonte Institutin e bujqësisë Biologjike për Veriun.

Ndarja e tij nga jeta është e trishtueshme, duke lënë në mes shumë ëndrra siç ishte botimi për Perimekulturën që dhe unë isha një bashkëpunëtor i ngushtë i tij.

Mesazhet e ditëve të fundit janë tepër prekëse, por jeta është e tillë.

I shpreh ngushëllime bashkëshortes, djalit, vajzës dhe të gjithë të afërmeve të tij kudo që ndodhen, si dhe gjithë ish grupit të Oxfamit në Shqipëri e specialisteve të bujqësisë, për humbjen e jetës së Tofik Fugarinit. Pushofsh në paqe!

Përgatiti Zef Nika e Majlinda Prik

SEKSUALITETI DHE SPIRITUALITETI

(NË NDERIM TË NËNË TEREZËS)

DITA, 20 TETOR 2020

Dr. Adem Harxhi

Seksualiteti dhe spiritualiteti janë shumë të afërt me njeri-tjetrin. Për këtë ka fakte. Shkenca mbi trurin, ka vërtetuar se qendrat nervore të spiritualitetit dhe seksualitetit në tru, janë të vendosura shumë afër njëra tjetrës. Në eksperimente është provuar se veprimi mbi njërin qendër, ndikon edhe tek tjetra. Këtë lidhje midis tyre, një klerik i njohur, e shpreh shumë bukur e thjeshtë kur thotë: “Po qe se pas rrëfimit, nuk ndryshon seksualiteti i atij, ose asaj që rrëfëhet, kjo tregon se procesi i rrëfimit nuk ka qenë as i thellë, as i plotë dhe as efektiv”.

Ata që kanë lexuar këngën e Solomonit në Bibël, e kuptojnë këtë lidhje. Kjo “këngë e këngëve”, është një koleksion i poezive lirike që i gëzohen dashurisë njerëzore. Poezia e përshkruan natyrën dhe trupin e burrit e të gruas me erotizëm të pasionuar:

Sa e bukur je dhe sa e hijshme je,
o e dashura ime, me të gjitha ëndjet që siguron!

Shtati yt është i njëllotë me atë të palmës

dhe sisët e tua janë si vile.

Kam thënë:

“Do të ngjitem mbi palmë dhe do të kap degët e saj”.

Qofshin sisët e tua si vilet e rrushit,
aroma e frymës sate si ajo e mollëve.”
(Bibla shqip, 7/6,7,8. faqe 715)

Në të gjithë historinë njerëzore, poezitë erotike më të mirat e më të bukurat i kanë shkruar priftërinjtë dhe murgjit. Kjo nuk mund të jetë rastësi. Prift dhe murg i mirë është ai, që e do në mënyrë më pasionante Zotin. Kjo do të thotë, që ai, ose ajo, duhet të jetë pasionant, një person seksual.

Si shpjegohet atëherë, që disa njerëz, shumica prej tyre religjiozë, zgjedhin dëlirësinë dhe beqarinë si mënyrë të jetuari?

Për këtë ka dy arsye.

E para: Ata që zgjedhin të mos kenë marrëdhënie me njerëz të tjerë, vendosin të jenë shumë të përbajtur seksualisht. Ata zgjedhin beqarinë dhe dëlirësinë. Këto janë çmimi që duhet të paguajnë, për këtë zgjedhje që kanë bërë. Dhe ata e gjejnë këtë çmim, të meritueshëm.

Arsyeja e dytë është thellësisht religjioze. Ata zgjedhin beqarinë sepse nuk duan të largohen nga dashuria e tyre për Zotin. Ata nuk duan të bëhen viktimat të dashurisë njerëzore. Ata e dinë, siç thosh Shën Augustina: “Ju na bëtë ne për Vetën Tuaj, i dashur Lord, dhe ne nuk mund të gjejmë qetësi të vërtetë veç tek JU”. Dhe... kjo bëhet e mundur, kur marrëdhëniet me Zotin, zënë vendin e parë.

Si bëjnë me urinë seksuale, ata që kanë zgjedhur si opcion të jetës së tyre, dëlirësinë dhe beqarinë?

Rekomandimet janë thënë shumë thjesht. Të gjejnë aktivitete të tjera, që energjitë seksuale t'i harxhojnë në mënyrë shpirtërore të dobishme. Kjo është

mënyra më e nderuar, që mposht urinë seksuale. Duhet ajo që frojdianët e rinj e kanë quajtur” aktivitetet sublime”.

Nënë Tereza kishte gjetur zgjidhjen më të përsosur. Energjitë e saj seksuale ajo i shndërroi në dashurinë pa kufi për më të varfrit e botës. Të gjesht Krishtin në fytyrën plagë, të atyre që vdesin, është mrekullia që e shndërron dëshirën seksuale në admirim pa fund dhe madhësi për Zotin. Ajo jep satisfaksion personal të jashtëzakonshëm.

Gruaja e famshme shqiptare, Nënë Tereza, kishte gjetur një mënyrë që ishte më e mira nga të gjitha mënyrat. Nënë Tereza e dashuron Krishtin, nëpërmjet dashurisë prej shenjtoje për njerëzit. Ajo gjeti kënaqësinë e jetës së saj tek Krishti. Ajo pret ta përshëndesë Atë, tek çdo i varfër dhe i sëmurë që ajo e donte dhe i shërbente. Nënë Tereza thoshte: “Dashuria

themi, siç je martuar ti me bashkëshorten tënde.” –u shpreh një herë rastësisht Nënë Tereza. Dashuria shpirtërore e kompenson dëshirën fizike. Shërbimi plot dashuri për njerëzit, është një formë e sublimimit që e vë trupin nën kontroll. Eksperienca religjioze është potencialisht seksuale.

Nënë Tereza është e paarritshme. Asnjë njeri në këtë botë, sado kristian të jetë ai, nuk matet dot me Nënë Terezën. Askush, nuk mund të përdorë mënyrën e saj të sublimimit, për dëshirat seksuale. Por, ajo që gjithkush mund të bëjë, është të gjejë ku t'i shpërndajë energjitë e tij seksuale, nëpërmjet oportunitetëve që janë kudo, sipas mënyrës e mundësive të tij. Rëndësi ka fakti, që të dashurojmë ata që janë në nevojë dhe të padashuruar. Ky është mësimi i madh që jep Nënë Tereza me jetën e saj, për të gjithë njerëzit dhe kristianët e botës.

që fliste përveç shqipës, që ishte gjuha amtare, edhe serbokroatishten dhe turqishten.”

Ajo ka doktoraturat, mirënjohjet, dekoratat dhe titujt më të larta dhe më të shumta nga çdo njeri tjetër në këtë planet. Askush nuk ka arritur ti numërojë ato sa ishte gjallë Nënë Tereza, sepse pa mbaruar lista, Ajo merrte të tjera.

Ajo nuk pranoi ndere dhe ceremoni. Shpenzimet që do të bëheshin për ceremoninë e dorëzimit të çmimit Nobel, Ajo, u a ndau të varfërve. Ishte hera e parë që çmimi Nobel dorëzohej pa ceremoni të bujshme.

Është në nderin e të gjithë shqiptarëve, që trojet tona të bëhen vend pelegrinazhi, për të gjithë adhuruesit e shumë të Nënë Terezës, kudo ne botë. Këtë na i do zëmra të gjithëve. Por që të arrihet kjo, nuk duhet të këtë më lypsa nëpërmjet trotuarit e



për Krishtin i ishte ngulur aq shumë në zemër, sa që e shihte Atë, tek kushdo që i shërbente.” Personi i parë, që gjeti në rrugë të Kalkutës me fytyrë të ngrënë nga krimbat dhe minjtë, nuk mund të ishte tjetër, thoshte Nënë Tereza, veçse Krishti i braktisur. Në shtëpinë që kishte ngritur për ata që ishin duke vdekur, ajo shihte në çdo trup të drobitur, vuajtjet e Krishtit që jep shpirt. Për të dhe për bashkësinë e saj, Krishti, është në çdo plagë leproze që pastrojnë, në çdo fëmijë që ushqejnë, në çdo trup të kredhur në urinë që e lajnë.

Ja si shprehet ajo vetë: “...ndryshe, nuk do të mundja të kujdesesha me dashuri njëllotë për të gjithë. Njerëzit më pyesin shpesh, se si mund ta pastroj plagën e qelbur të leprës. Më thonë: ‘Ne nuk do ta bënim as për para dhe as për dhimshuri’. Ua kthej: As ne nuk do ta bënim. Por e bëjmë për dashurinë ndaj Tij”

Betimi që ato kanë bërë për besnikëri të papërlyer, kërkon që zëmra e tyre t'i jepet Krishtit. “Jam martuar me Të, si ta

Nënë Tereza, është një shpirt që i ka kapërcyer të gjitha dallimet racore, fetare, dhe kombëtare. Ajo nuk kërkoi favore, ndere e mbretëri. Ajo ishte një këngëtare e vërtetë e Zotit, tërësisht, e përkushtuar për të lehtësuar dhimbjen e të tjerëve.

Edhe pse Nënë Tereza është e të gjithë botës, ne kemi privilegjin të jemi bashkëkombës të saj. Ajo e ka pohuar këtë me gojën e saj. Ajo e pohoi këtë kur mori çmimin Nobel në Oslo, më 1979. Po në këtë ceremoni, vëllai i Nënë Terezës, Lazari, tha: “Kur ishte fëmijë, Atë nuk e thërrisnim Anjeze, por Gonxhe, që në gjuhën shqipe do të thotë ‘lule që s’ka çelur ende, burbuqe’, sepse ajo ishte faqekuqe dhe topolake si gonxhe trëndafili. Mbahej pastër si drita dhe ishte e papërtuar”.

At Celeste van Eksem, udhëheqësi shpirtëror i Nënë Terezës, në ditët e para kur njohu Nënë Terezën thoshte: “Ajo e përshkruante babanë e vet, Kolë Bojaxhiun, si një person të njohur në Shkup,

Shqipërisë. Duhet luftuar varfëria, ashtu siç luftoi me të, Nënë Tereza. Le të heqim të gjithë diçka nga vetia, për t’ua dhënë atyre që kanë nevojë. Ata që nuk e kanë mundësinë të ndihmojnë materialisht, le t’u falin dashurinë dhe ngrohtësinë. Ndërsa ata që rrojnë në luks, dhe nuk dinë ç’ta bëjnë pasurinë e pamerituar që zotërojnë; ata që kanë obligimin të luftojnë me varfërinë që ka pllakosur këtë vend dhe nuk bëjnë asgjë për të; ata ndjehen keq, kur kuptojnë se forca e Nënë Terezës qëndronte tek varfëria e saj. Ja pse ata flasin dhe bëjnë pak në nderim të Shenjtores shqiptare, edhe atëherë kur janë të detyruar ta bëjnë këtë, siç janë këto ditë të shenjtëritimit të saj.

Nënë Tereza ishte nëna e më të varfërve dhe më të sëmurëve të botës. Monumenti më i mirë për Të, do të ishin trojet tona pa të varfër.

MISIONI I PAQES

NJË TAKIM I PAHARRUAR NË “MISIONIN DIPLOMATIK PËR PAQE E PROSPERITET” NË TIRANË



Ditë e veçantë në ambiente dhe me njerëz të veçantë, do ta përshkruaja me një fjali të vetme këtë eksperiencë që përjetova ditën e diele me datë 27. 09. 2020 në ambientet e selisë së Misionit Diplomatik për Paqe e Prosperitet të akredituar në Tiranë.

Ishte hera e parë që merrja pjesë dhe kurioziteti ishte shumë i madh ta shoh nga afër se si funksionon ky mision, organizimin e tij institucional, si dhe programin e këtij misioni për paqe e prosperitet në përcimin dhe realizimin e tij në mbarë globin.

Megjithëse në kushte të kufizuara, të cilat tashmë dihet se në mbarë globin janë frenuar dhe paralizuar aktivitetet kulturore, sportive e sociale, për shkak të ruajtjes dhe mbrojtjes nga pandemia që po sundon botën prej muajsh, nuk e frenuan as nuk e ndalen këtë institucion të vazhdojë aktivitetin e tij në kryerjen e detyrimeve që ka karshi misionit të shenjtë të shpërndarjes së paqes në mes të njerëzve dhe evidentimit të personaliteteve, të cilët nuk reshtin së kontribuar për paqe dhe prosperitet për njerëzit dhe komunitetet ku jetojnë e veprojnë.

Një organizim i thjeshtë, por me peshë të madhe do ta quaja, për faktin se të gjithë të pranishmit ishin personalitete të rëndësishëm në fusha të ndryshme të jetës dhe të ardhur nga treva të ndryshme etnike, aq sa ndihesh si në një seli të vërtetë ku mblidhen ndërkombëtarët, por me gjak shqiptar e ku nocioni i paqes mori kuptim shpirtëror e vëllazëror.

Ndër të pranishmit që e benë tepër dinjitoze këtë veprimtari mund të veçoj Guvernatorin e këtij trupi diplomatik Dr. Shefki Hysa, por dhe veprimtarë të shquar të këtij misioni, Dr. Agim Shahini, Dr. Kristo Koçi, Gjeneral Dedë Prenga, si dhe shumë personalitete të tjerë, një pjesë e të cilëve ishin edhe anëtarë të këtij misioni diplomatik.

E veçanta e gjithë këtij organizimi ishte ambienti, i cili ishte i tejmbushur me simbole kulturore që dëshmojnë paqe, prosperitet, dinjitet dhe vlera humane, duke filluar nga flamujt, fotot, librat, broshurat e deri tek buste apo shtatore të individëve të shquar që kanë dhënë kon-

tribut të paçmuar për paqen dhe begatinë në botë, të cilat mesa duket do vendosen në qendrat urbane në po ato komunitete, siç ishte rasti i vendosjes së shtatoreve të Prof. Dr. Anton Çeta në Rrëshen të Mirditës.

Ky takim nuk ishte i rastësishëm, por i mirë menduar dhe akoma më i mirë organizuar, pasi pikërisht në këtë ceremoni do vlerësoheshin dhe pranoheshin edhe katër anëtarë të rinj në këtë familje të madhe, e cila në bazë të flamujve të vendosur mbi tavolinë, mund të them se ishte e gjithë bota e përfaqësuar.

Ajo që e bëri akoma më surprizues këtë takim ishte fakti se dy nga të vlerësuarit ishin misionarë në misionin e tyre religjioz e njëkohësisht edhe misionarë të betuar në vazhdimin e ecjes në rrugën e pajtimit që shtroi i madhi Anton Çeta.

Këta misionarë të fjalës së Zotit dhe të dorës së pajtimit ishin Mullah Fetah

Nëna Terezë”.

Ishin pikërisht fjalët e rastit të mbajtura gjatë prezantimit ato që e benë tepër emocionuese këtë ceremoni, ku për ta u thanë shumë fjalë me peshë, të cilat të gjithë të pranishmit do t'i mbajnë mend gjatë.

Me po aq emocion u përcollën edhe dy vlerësimet e tjera, për të cilët pati edhe duartrokitje në prezantimin e civive të tyre nga të pranishmit, ku për z. Ideal Qollaku, biznesmenin nga Prizreni, i cili u vlerësua me titullin “Misionar dhe Ambasador i Paqes” për humanizmin e pashoq, aq sa pasuria e tij dukej si një burim shprese për nevojat e komunitetit dhe njerëzit në nevojë.

Me po kaq nderim u vlerësua edhe civia e znj. Rita Shkurtaj, malësorja fisnike, e cila si studiuese, gazetare dhe misionare në fushën e edukimit, po jep më të mirën nga vetja për kohën dhe njerëzit, sidomos në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë



Bekolli dhe Mullah Xhevat Kryeziu, të cilët në civilin e tyre kishin merita të padiskutueshme për t'i merituar vlerësimet edhe si Misionarë të Paqes, ku Mullah Xhevat Kryeziu u vlerësua me Medalien e Artë “Urdhri i Misionarit të Paqes

kulturore, por edhe përcimin e paqes në kohë të vështira që sot kalon njerëzimi.

Drejtuesit dhe organizatorët u shprehën se jo më kot e lamë për në fund vlerësimin me titullin “Misionare dhe Ambasadore e Paqes” për këtë zonjë të nderuar,



Rita Shkurtaj, që ishte e vetmja veprimtare e shquar nga Malësia e Madhe.

U ndjeva i privilegjuar si gazetar që më dhanë mundësi të zë vendin më të mirë për ta filmuar dhe fiksuar çdo moment gjatë kësaj ceremonie, çka më dha emocione të shumta, sepse gjithçka më dukej një botë ndryshe e gërshetuar me ngjyrat e flamujve dhe veshjet përkatëse që përdorte kjo trupë diplomatike.

Mbresa tejet të veçanta më lanë edhe fjalët përshëndetëse në të cilat kishte shumë shprehje filozofike e fjalë të urta popullore, që na bëjnë të marrim mend e t'i peshojmë fjalët dhe veprimet tona.

Për këtë emocion kaq të veçantë gjej rastin të falënderoj në mënyrë të veçantë z. Ndue Dodaj që më mundësoi këtë pjesëmarrje, të cilën mund ta quaj një nga ditët më të veçanta që kam përjetuar.

E veçanta e emocioneve të mia lidhej edhe me fushën time të krijimtarisë poetike, ku mu duk vetja si para një njeriu gjigant tek këndonte me vargje të improvizuara në çast rapsodi dhe kantautorit i shquar mirditor dhe mbarëshqiptar z. Gjon Frroku “Mjeshtër i Madh”, i cili u dedikoi disa herë këngë anëtarëve të rinj që morën vlerësime, si dhe misionit diplomatik, aq sa tek sofa e shtruar, unë nuk ngurova ta them në mes të pranishmëve vlerësimin tim për këtë mjeshtër të madh.

Mes këtyre emocioneve më mbeti në mendje një shprehje e thënë nga i Madhi Anton Çeta. Kur i kishin thënë t'u këndoftë kënga ai ishte përgjigjur...”Të këndohet kënga për së gjalli nuk është mirë, se njeriu mund edhe të gabojë dhe ta gërvishtë këngën e tij”.

Duke i uruar suksese të mëtejshme Misionit Diplomatik për Paqe e Prosperitet e në veçanti guvernatorit të saj z. Shefki Hysa, njëkohësisht edhe miku im, përgëzoj të gjithë ata që morën vlerësime emër për emër, njëkohsisht iu shpreh mirënjohje dhe respekt të gjithë të pranishmëve, të cilët më mbushen me krenari kombëtare, me vlerat njerëzore, që ata kishin ndërtuar në kornizën e tyre të identitetit.

Nga **Ramazan Çeka**

“LULEBORË-FEST 2020”

Lulëzoi sërish “Lulebora” në Shkodër edhe pse pak ndryshe nga herët e tjera. Sa herë vjen stina e vjeshtës bahçet shkodrane veshin petkun e saj plot nure dhe nuanca, ku askund si në Shkodër nuk e gjen këtë harmoni drite dhe arome të këndshme që kundron prej së largu. Akoma më përallore këtë atmosferë e bën shpirti artistik i shkodranëve, të cilët lindin dhe jetojnë me këtë harmoni stinore e ku zemrat ua çon peshë mbretëresha e bahçeve dhe e këngës, “Lulebora”.

Të dashuruar me jetën e të etur për artin, askush dhe asgjë nuk e pengon Shkodrën ta trashëgojë e ta kultivojë ndër breza atë që me shumë mund e përkushtim e kanë ndërtuar prej vitesh, Festivalin e Këngës Qytetare “Luleborë”, i cili falë mbështetjes dhe përkujdesjes së Bashkisë Shkodër, përkushtimit dhe obligimit të stafit të artistëve të Teatrit “Migjeni” nën kujdesin e veçantë të drejtoreshës Rita Gjeka, si dhe pasionit të këngëtareve, kompozitorëve, orkestruesëve e tekstshkrusëve, u bë i mundur realizimi i tij në mënyrën më perfekte të mundshme edhe pse akoma lëvron frika e prezencës së koronës si pandemia e kufizimit të jetës normale.

S’kishte si të ishte më bukur se kaq. Edicioni i pestë i Festivalit të Këngës Popullore Qytetare “Luleborë” erdhi me risi të reja dhe rregulla ndryshe si pasojë e Pandemisë. Një skenë e improvizuar në shkallët e jashtme të Teatrit mbi të cilën ishin instaluar projektor që reflektonin në ndriçimin e tyre nuancat e ylberit, një foni e fuqishme që të ngrinte peshë gjithë qytetin dhe si kurrë më parë shumë spektatore që kishin mbushur të gjithë sheshin, jashtë rrethimit të Teatrit. Kjo veprimtari u organizua vetëm një natë, pa orkestër, me bazë muzikore, me daljen e këngëtarëve në skenën e improvizuar tek sheshi i Teatrit, me prezencë të kufizuar pjesëmarrësisë.

Megjithatë atmosfera e veçantë e krijuar, ndërthur bukur me një 21 këngët e reja që i shtohen fondit të pasur të muzikës shkodrane dhe asaj shqiptare. Këngëtarë pjesëmarrës në këtë garë ishin: Klodiana Vata, Karajfilat, Sevina Kurti, Arber Bala, Uendi Zylja, Laurjan Ejlli, Xhuli Pjetraj, Glerdit Turmetaj, Artemisa Mithi, Martina Serreqi, Blerta Cina, Rezarta Smaja, Mukades Çanga “Mjeshtre e madhe”, Hajro Pepa, Adelina Correj, Nimet Lekaj, Kristi Ndoja, Megi Toma, Niki Mjeda, Savjana Vjerdha, Silvia Kacarosi, Orjeta Kelaj, Riza Bytyqi, Aida dhe Ketlin Pjalmi.

Edhe pse në kushte krejt të reja, shkodranët dinë të përshtaten, ndaj si kurrë më parë pati spektatorë mbështetës të artistëve që veç brohoritjeve, pankartave e fishkëllimave, në mes tyre ra ne sy flamuri kuq e zi që valëvitej gjatë gjithë kohës.

E veçantë tjetër e këtij festivali ishte pjesëmarrja e Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, shoqëruar nga drejtues vendor, si dhe biznesmeni Agron Çela dhe drejtori i televizionit TV1 Channel z. Edmond Ndou, por si gjithmonë e pranishme në aktivitete kulturore ishte

edhe Kryetarja e Bashkisë znj. Voltana Ademi, e cila është vërtetë një artiste, Prefektja Majlinda Angoni, si dhe shumë autoriteteve të tjerë të Shkodrës, çka i dha shumë më tepër seriozitet këtij eventi kulturor, që pas një kohe shumë të gjatë pauze, për shkak të masave ndaj pandemisë, kishin ngrirë, për t’u rikthyer me këtë festival kaq të bukur.

Festivali “Luleborë” 2020 ishte në edicionin e tij të pestë pas rikthimit nga harresa shumë vjeçare. Çuditërisht ky edicion solli mrekullira në festën e tij. Zëra brilant e të fuqishëm që edhe pse këndonin live,

përformuan këngë që tejkaluan çdo pritshmëri. Talente të reja me larmi ngjyrash e me një shpërthim vokalesh, çka e bën të sigurtë stafetën që këngëtarët e vjetër të “Luleborës” dhe “Karajfilave të Shkodrës”, po ua dorëzojnë brezit të ri. Një tjetër e veçantë e këtij festivali ishte prezantimi nga i talentuari skenik z. Enkel Demi, i cili gjatë gjithë prezantimit të këngëve arriti t’i shoqëronte me monologje retorike dhe humorin e hollë e plot sharme të shkodranëve, duke e bërë akoma më të bukur këtë spektakël.

Festivali “Luleborë” me udhëheqës ar-

tistik Roland Guli dhe Ilir Zoga, në këtë edicion solli gjithçka të bukur, ku nuk munguan as duartrokitjet vlerësuese të spektatorëve pas interpretimit plot ndjenjë të këngëve. Asgjë si la mangut festivalet më të mëdha kombëtare, pothuajse të gjithë këngëtarët në fjalën e fundit falënderuese pas performancës, dëshmonin për vendlindjen me të pavdekshmen e të gjitha kohërave përshëndetjen “fale-minders” si një firmë dialekti që vetëm në Shkodër ta thonë.

Në skenën e këtij festivali erdhën mjaft këngëtarë të rinj që premtorin shumë me talentin e tyre, të cilët erdhën me këngë të përzgjedhura me shumë kujdes, ku merita po aq të mëdha për realizimin e tyre kanë edhe kompozitorët, orkestruesit e tekstshkruesit si: Zef Çoba, Shpëtim Saraçi, Edmond Zhulali, Ilir Zoga, Roland Guli, Tonin Tarnaku, Oleg Gjerga, Enis Mullaj, Lekë Jakova, Kolec Gajtani, Anton Kaftalli, Gazmend Kraja, Andi Unaza, Bardhyl Hysa, Jetmir Mehmetaj, Bep Vjerdha, Shkodra Elektronike, Namik Jahja, Valton Beqiri, e të tjerë, si dhe poetët e mirënjohur: Alfred Çapaliku, Jorgo Papingji, Osman Kozmaj, Franc Nogaj, Juli Ndoci, Erjona Rushiti, Denisa Domnori, Ambra Hysa, e të tjerë.


Të gjithë këta artistë u evidentuan edhe në skenarin e përgatitur nga znj. Ermira Alia me mjaft eksperiencë në këtë drejtim. Me shumë kureshtje dhe emocion u prit edhe vlerësimi i jurisë, e cila përbëhej nga: Lorenc Radovani (kryetar), Markelian Kapedani, Bujar Qamili, Zija Vukaj dhe Vlashen Sata, të cilët nuk e patën aspak të lehtë të vlerësonin e të vendosnin për çmimet, çka u vu re edhe në vonesën e gjatë pas kuintave, sa edhe prezantuesi Enkel Demi e kaloi në monologje humorit, të cilat i dhanë akoma më tepër shije asaj pritje. Dhe si në çdo garë jo të gjithë fitojnë. Me çmim të parë u vlerësua kënga me titull: “Ke shku” me tekst të Erjona Rushitit, kompozuar dhe orkestruar nga Enis Mullaj, kënduar nga artistja e re Savjana Vjerdha.

Çmimi i dytë i këtij Festivali shkoi për Silvia Kacarosi me këngën «Kadalë» me tekst, kompozim dhe orkestrim Shkodra Elektronike.

Nga Ramazan Çeka



*** POEZI *** ** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI ***



LULASH BRIGJA, 2020

VJESHTA TROKITI

Vjeshta trokiti në qytetin tim
Pluhurin e verës e lau një shi
Plot me studente u mbushën rrugët
Shpirtin ma mbushi një poezi

Me gjethe të pemëve era zbavitet
Ka marr qyteti një tjetër ngjyre.
Ikën dallëndyshet andej nga jugu.
Liqeni hënës i bëhet pasqyre.

Vjeshta trokiti në qytetin tim.
Rrugët dhe kafet u mbushën plot.
Po troket dimri dhe pleqëria.
Por unë asnjërin si ndaloj dot

Puthjen e diellit më shumë e duam
Malet përreth i rroku një mjegull.
Njerëzit kur ecin .. gati vrapojnë.
Sikur të gjithëve u pikon një tjegull

Ndërrohen brezat në auditorë
Si gjethe që bien në vjeshtën e vonë.
Mi vrasin vargjet edhe frymëzimin..
Do ikim , do ikim ...- Të gjithë me thonë.

Vjeshta trokiti në qytetin tim
Çdo çast të bukur dua ta shijoj
Duke shpresuar që viti tjetër
Të jete më i mirë se viti që shkoj .

VARGJE SPITALI

Nata fresk aromë ilaçesh.
Asnjë zhurmë gjithçka e qetë
Vetëm hapi i infermieres.
Që është sonte turni i tretë!
Një pacient 80 vjeçare..
Në dritare rrinë mbështetur
Kushedi nëpër kujtime
Ku po bredh, e ku ka tretur.

Heshtjen vret një zë i ëmbël,
Një shikim shumë engjëllorë
- Çka po sheh.? Çka po t' kujtohet.

Hajde rrimë o burrë malësorë?
Infermierja kaçurrele..
Ndan një mollë plakut zoteni.
- Nesër do bëhesh më mirë
Nesër ... do jesh në shtëpi

S'po më tremb moj bijë spitali
Vdekjes kurrë nuk ju frikësova
Ajo vjen kur ta thotë Zoti.
Jetën time e jetova
Si n 'shtëpi dhe në spital.
Fjala është ilaç , derman.
Nëse nis vdekja me ardhur
Ndryshon rrugë prej syrit tan.

Ti je engjëll buzëbardhë
Ti je njeri që mbjell paqe.
Sa herë që ti je në shërbim
S'do doktor, s'dua ilaçe.
Në t 'vërtet rruga e jetës
Në spital nis dhe mbaron.
Lum ata që bëjnë mirësi
Se vetë Zoti i bekon ...

NA RA KJO E KEQE!

Na ra kjo e keqe dhe u ndamë
E kur do të shihemi se dimë.
S 'patëm kohë për lamtumirë
As kafen e ndarjes nuk e pimë
Na ra kjo e keqe dhe mësuan
Se sa e rëndë qenka vetmia.
Si zogj të mbyllur në kafaz.
Nuk del buzëqeshja as poezia

Na ra kjo e keqe dhe kuptuam
Se sa e shtrenjtë qenka liria.
Pa zhurmë , pa njerëzit , pa punën
S' ka shije as kafja, as shtëpia
Na ra kjo e keqe dhe mësuan
Se askush se di çfarë do të ndodhë
Se lotin e buzëqesh, se jetën e vdekjen
i ndan vetëm një fije e hollë

Na ra kjo e keqe papritur.
Dhe nisem të flasim me vete
Se vetëm mirësia e dashuria.
Janë e bukura e kësaj jete
Na ra kjo e keqe dhe u ndamë
Ndoshta ishte një ëndërr e trishtë
Por shpresat ende nuk janë sosur
Po ikën po ikën ky vit i brishte!

BISEDE ME VJERSHTËN...

Era po mbledh gjethe e vjeshtës
Para syve të mi
Po e zhvesh natyrën
Sikur e zhveshën vitet kokën time.
Krenohet vjeshta se po i godit shtratin pranverës.
Ndërsa në kokën time stisën ca vargje
Që ngajnë me "Iluzionet e humbura".

E humbi natyra cicërimën e zogjve
Aromën e luleve ,zhëgun e verës
Fajtoje pa faj quhet vjeshta
Qe po jeton, jetën e saj.
Zhvesh bluzën e gjelbër
Vishet me gri dhe qeleshe të bardhe.

Mos u mërzi o vjeshta ime.
Se gjithçka tjetërsohet në ketë bote.

Nesër do ti marr malli për ty.
Ata që po të shohin me përbuzje sot
Se njerëzit janë krijesa të pangopura
Asaj që nuk e kanë ja hapin derën
Thesaret që kanë të vetat.
I humbin pastaj jua dinë vlerën.

I humba shokët e fëmijërisë.
Kur kurbeti na bëri me dorë.
Kur këtu bie dielli, atje është mbrëmje vonë
E lash shtëpinë e vjetër
Kur bëra një tjetër në fushë.
Por tani boshllëkun e saj, askush nuk ma mbush.
Më braktisi mikja ime
Kur mori vesh se jam martuar
Por tani më lutet si fëmije
vetëm një herë për tu takuar
Kur puna na bëri si robotë
U dhunuan ëndrrat me ne
Por paraja nuk paska asnjë vlerë.
Kur skllavi i saj gjithmonë je?

I humba lidhjet me fqinjen
Kur ja kujtova një borxh të pakthyer.
Kur nuk ju len leke
As kafen nuk vijnë për ta shërbyer
Falsë ato që fliten
Falsë çfarë hamë e çfarë pimë
Të gjithë ankohen se s'ka shtet
Por rregullat krejt pak i zbatojnë
Thonë se ka humb dashuria.
Por këmishët e veta i tradhtojnë
I humbi vlera librit ...
Lulëzoi interneti dhe korrupsioni
Prandaj nuk mërziem me ju edhe nëse se lexoni

Sot do eci pa çadër le të më lag ky shi vjeshte.
Të dehem me kujtimet e mija.
Të çmallem me to në heshtje.
Po kujtoj festat e vizitat
Që sot njerëzit gati po i harrojnë
Ah - Kur s'ta kanë interesin , bëjnë sikur s'të shikojnë
Prandaj o vjeshte e dashur
Ti mos u mërzi kot.
Se njerëzit behën të varfër në shpirt
Kur xhepat e barkun e kanë plot.

MOS PRIT?

Të kërkoj në rrugët e qytetit
Nuk je ... As nesër nuk do jesh
Ka mbetur imazhi jot i ëmbël
që para syve me buzëqesh...

As gjurmët e tua në rërë...
As kafja jote mbi tavolinë
Veç dielli i skuqur në horizont
dhe malli që puthet më vetminë..

Ti je ... atje ku nuk je!
Aty ku ke shpirtin mungon...
Po ikin korriku e gushti
dhe dielli mbi liqen perëndon.

Mos prit ylberin e vjeshtës.
që të ndodh për ty mrekullia..
Kërko në shtigjet e të pamundurës
rrugën që të çon tek dashuria...

JASTEKU

Në netët pa gjumë
veç unë dhe jastëku
Aty fle si engjëll,
aty në gjumë vdekur.
Aty bëhem flutur, ylberin kaloj.
Me ty o i dashur fle dhe ëndërroj.

Shpesh pa fjetur hiç,
të dy jemi zgjuar
Me lot laj jastëkun
nga shpirti i trazuar...
Pa ato që desha, dhe i meritoj
Se di pse buzëqeshi as dua të lotoj

Unë edhe jastëku
... si dy miq të mirë
Qajmë dhe qeshim bashkë
ndihemi të lirë ...
Kënaqemi me pak asgjë s'na mungon
Ne jemi vetvetja dhe kjo na mjafton

Në netët pa gjumë
duke ndarë sekrete.
Ne numërojmë se bashku
hallet e kësaj jete
Unë edhe jastëku në një poezi.
Aty meditoj ,shpirti gjen qetësi..

ASGJË ...?

Çdo ditë ...
shtohet nga një pikëpyetje
Çdo ditë ...
nis e mbaron me kacafytje.
Si toka,
që zihet me qiellin,
e pastaj me detin.
Ashtu ngatërrohen çdo dite,
ëndrrat me realitetin

Det pafund,
më duket historia,
ku njerëzit behën thjesht fosile.
Qielli një mjegullnajë ëndrrash.
Toka shkretëtirë me gamile.

Mes meje dhe realitetit,
kurrë nuk pati qetësi ...
Sa shpesh e pyes veten
Ku jam ...?
Ku jam ... se ... s'po di..

Ëndrrat më çojnë në qiell.
Historia më hedh në det.
Toka një skenë gladiatorësh
që qelbet nga njerëzit e vet

Kur lodhem duke shkruar,
kur dehem duke menduar,
kujtoj Omar Khajamin,
dhe them ... Jam unë i gabuar?
Asgjë...,
nuk marrim me vete ...!
Kalimtarë jemi në ketë jetë ...
Me mirë, e më gjate jetojnë ata
që i futin një mendje të letë.

NE NDËRTOJMË

Sergei Mikhalov

Çdo gjë është e mirë në botë,
gurët, rëra edhe balta.
Çdo gjë është e mirë në botë,

çekiçi, gozhdët edhe dara.

Është lopata dhe janë penjtë,
që të qepni e të gërmoni.
Djema punën mbajeni të shenjtë,
mëshohuni punën fort ta doni!

*Përktheu nga Rusishtja:
Vëlla Nikolin Sh. Lëmezhi*

GOZHDA MBI TRUPIN TËND...

Megjithëse
Ti u ringjalle
të tretën ditë.
Tashmë,
pas mijëra vitesh,
me habi,
mbi trupin Tënd
të shenjtë,
shoh gozhda
përsëri,
o Zot Jezus!
Prandaj,
me zemër të lutem:
Ki mëshirë për mua
dhe për të gjithë ata
që akoma
Ty të kryqëzojnë!

*Vëlla Nikolin Sh. Lëmezhi
Shkodër, më 06. 09. 2018*

SA MISTER I BUKUR!

*"...të dobët në sy të botës i zgjodhi Hyji,
për t'i turpëruar të fortët". (1 Kor. 1, 27)*

Sa mister i bukur,
Ti, o Zot,
se ëmbëlsisht
në vogëlsira
e në hollëlsira
banon,
më shumë
se kudo,
dhe bota,
pikërisht këtë,
nuk kupton!

*Vëlla Nikolin Sh. Lëmezhi
Shkodër, më 24. 07. 2018*

MBI SHKOPIN TËND...

*(Kushtuar nënës Luke)
"Me gjithë shpirt dua je babën tënd
dhe mos i harro ofshamet e nënës sate!
Mos harro se s'do të kishe qenë pa ta,
e çka do t'u japësh siç të dhanë ata?".
(Siracidi 7, 29-30)*

Shkopi ku ti mbështeteshe,
tek e shoh plot mall.
Në zemrën time prej biri,
ç'ndjenja seç më ngjall!

Shkopi ku ti mbështeteshe,
i shkurtër si ti vet'.
I heshtur dhe i palëvizshëm,
o Nënë, sa shumë më flet!

Shkopi ku ti mbështeteshe,
është i shenjtë për mua shumë.
Se aty, tashmë o Nënë,
vazhdimisht mbështetem unë.

*Vëlla Nikolin Sh. Lëmezhi
Shkodër, më 07. 03. 2020*

SI ËNDËRR...

*"Lini fëmijët të vijnë tek unë
e mos i ndaloni;
sepse atyre u përket
Mbretëria e Hyjit!". (Marku 10, 14)*

Si ëndërr ishte jeta,
kujtoj unë atëherë.
Të mbyllur dhe në terr,
nga një sistem i mjerë.

Fëmijë këmbëzbathur,
thjesht nën një çati.
Zemra seç kërkonte,
veç pak dashuri.

Në jetën si ëndërr,
kurrë nuk e harrova:
«Një shoqe të klasës,
për nuse e mendova».

O Zot, çfarë kujtimi,
sa shumë fantazi!
Një botë përrallore,
ajo fëmijëri.

Tashmë në jetën time,
gëzimi vërshon lumë:
Një nuse ëndërrova,
por m'u dha më shumë.

*Vëlla Nikolin Sh. Lëmezhi
Shkodër, më 19. 05. 2014*





Souvenir d'Albanie - Mar Lula i Shalës



Në Urën e Shalës në vitet '80



Nxënës dhe mesues të shkollës Palaj-Shosh, 2008



Kisha në Khan, 1938

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.



Mundësoi Botimin:

ELITA
bar-restaurant